

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5621  
E martë, 6 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

## MTI-ja ndalon shitjen dhe shërbimin e alkoolit dhe duhanit për të miturit

FAQE 9

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka lëshuar urdhëresë që obligon të gjitha bizneset që ta paraqesin në vendin e tyre shenjë për ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit dhe të pijeve alkoolike personave nën 18 vjeç



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE" KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË LUGINË, RAGMI MUSTAFA | FAQE 4-5

## Presim mbështetje më të fuqishme nga Kosova dhe Shqipëria

Kryetari i sapozgjedhur i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, ka vlerësuar se fitorja e tij tregon se Partia për Veprim Demokratik (PVD) është subjekt i së ardhmes. Ai ka thënë se Këshilli të cilin do ta drejtojë gjatë këtij mandati do të jetë mekanizëm shtesë për realizimin e lirisë individuale dhe kolektive të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka bërë me dije se prioritetet do t'i ketë cilësinë në arsim, kulturën, informimin si dhe përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Ai ka thënë se pret mbështetje më të fuqishme nga Kosova dhe Shqipëria si dhe një rol më aktiv të tyre



### AKTUALE

**SHUKRI BUJA THOTË SE DËNIMI NDAJ TIJ ËSHTË I ORKESTRUAR NGA NJERËZ TË POLITIKËS** F. 6

**MUSTAFA E QALAJ FLASIN PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË SIGURISË** F. 3

**RAPORTIMI FINANCIAR NË KOMUNA RRIËT EFIKASITETIN NË SHPENZIM TË PARASË PUBLIKE** F. 5

### EKONOMI

**RUKIQI: TË FOKUSOHEMI TE SEKTORI PRIVAT DHE ZHVILLIMI I TREGUT** F. 9

**KFOR-i GJERMAN DHURON PAJISJE DHE TEKNOLOGJI NË VLERË PREJ DY MILIONË EUROSH** F. 9

### KULTURË

**MINISTRI GASHI RAPORTON PËR TË ARRITURAT DHE SFIDAT NË MKRS-së** F. 6



### SPORT

**FAZLIU: FERONIKELI PËRMBI PRISHTINËN** F. 15

**INTERI PËR 'HAKMARRJE' NDAJ BARÇËS, NAPOLI PRET PSG-në** F. 15

ANALISTËT POLITIKË DHE PËRFAQËSUESIT E POZITËS NUK I SHOHIN ZGJEDHJET E REJA SI ZGJIDHJE PËR SITUATËN AKTUALE POLITIKE NË VEND

## Zgjedhjet e reja nuk do të prodhojnë asgjë të re

Njohësit e rrethanave politike dhe zyrtarët e pozitës kanë shprehur skepticizëm se zgjedhjet e parakohshme do të prodhonin diçka të re në skenën politike. Ata janë shprehur të bindur se zgjedhjet nuk janë zgjidhje hëpërhë. Zgjidhja më e mirë, sipas tyre, do të ishte arritja e një konsensusi politik ndërmjet pozitës dhe opozitës për disa çështje të rëndësishme kombëtare për vendin



**Edhe pas dy vjetëve ende nuk dihen arsyet e vdekjes së Astrit Deharit**

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kurzi: Serbia në BE vetëm nëse arrin zgjidhje me Prishtinën

**BEOGRAD, 5 NËNTOR** - Kancelari austriak Sebastian Kurz tha të hënën në Beograd se është e rëndësishme që dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës jo vetëm të vazhdojë, por edhe të përfundojë me sukses, sepse një gjë e tillë, siç u shpreh ai, është mënyra

e vetme për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. "Është një mundësi unike që historia të mbetet histori dhe së bashku të ecim drejt së ardhmes", tha Kurz në konferencën e përbashkët për media me presidentin e Serbisë, Aleksandar

Vuçiç. "Nga këndvështrimi im, ky dialog duhet të përfundojë me sukses dhe për këtë u kërkoj njerëzve që t'i mbështesin të gjithë politikanët që duan të marrin këtë rrugë. E kemi të rëndësishme bashkëjetesën paqësore, që e kaluara të mbetet e kaluar

dhe në këtë rajon të ketë qëndrueshmëri e paqe dhe jo shkatërrim e luftë", tha Kurz. Vuçiçi tha se Austria, edhe pse para dhjetë vjetësh e ka njohur pavarësinë e Kosovës, e mbështet çdo zgjidhje midis Beogradit dhe Prishtinës.



## Ministri Ismaili merr mbështetjen e deputetëve gjermanë për reformat në shëndetësi

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, është prituri të hënën në Berlin nga Komisioni për Shëndetësi i Bundestagut. Deputetët gjermanë shprehën gatishmërinë e tyre dhe të shtetit gjerman për mbështetjen e reformave për transformimin e shëndetësisë



Kryetari i Komisionit për Shëndetësi në Bundestag, Erwin Ruddle, duke përgëzuar ministrin Ismaili për punën që është duke bërë për transformimin e shëndetësisë në Kosovë, shprehu gatishmërinë e tij dhe të komisionit për ndihmë në këtë aspekt. "Ishte një takim shumë i mirë. Na vjen mirë për punën që është duke u bërë atje. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë çfarëdo bashkëpunimi për të cilin do të keni nevojë", ka thënë Ruddle. Përveç diskutimit për shëndetësi, ministri Ismaili ka kërkuar edhe mbështetjen e deputetëve gjermanë për liberalizimin e vizave për Kosovën, si vendi i vetëm në Ballkan pa të drejtën e lëvizjes së lirë.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**BERLIN, 5 NËNTOR** - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka nisur të hënën vizitën zyrtare treditore në Gjermani. Në ditën e parë të vizitës ministri Ismaili ka takuar deputetët e Komisionit për Shëndetësi të Bundestagut, në krye me kryetarin e komisionit, Erwin Ruddle. Duke folur për shende-

tësinë, ministri Ismaili u tregoi deputetëve gjermanë për reformat të cilat është duke i realizuar për transformimin e shëndetësisë kosovare.

Që këto reforma të jenë më të shpejta, ministri Ismaili kërkoj edhe ndihmën e Gjermanisë për t'i përmirësuar shërbimet shëndetësore. "Ne tashmë u kemi hyrë reformave të thella në shëndetësinë e Kosovës. Por, e rëndësishme për vendin tonë,

gjithmonë është e mirëseardhur ndihma e Gjermanisë. Edhe këtë herë ne diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit mes dy vendeve tona", ka thënë ministri Ismaili pas takimit.

Trajnimi i profesionistëve

shëndetësorë, binjakëzimet mes spitaleve, prurja e ekspertëve të ndryshëm nga Gjermania në Kosovë për ta ndihmuar përmirësimin e shërbimeve shëndetësore ishin disa prej kërkesave dhe temat e diskutimit.

## Zgjedhjet lokale në Shqipëri, më 30 qershor 2019

**TIRANË, 5 NËNTOR** - Zgjedhjet e ardhshme vendore në Shqipëri do të mbahen më 30 qershor të 2019-s. Vendimin e mori të hënën presidenti Ilir Meta. Javën e shkuar Meta organizoi për këtë çështje, konsultime dhe me kryetarët e grupeve parlamentare, ndërsa të hënën pati një takim dhe me kryetarin e Parlamentit, Gramoz Ruçi.



Në zgjedhjet e shkuara vendore koalicioni i majtë i udhëhequr nga Partia Socialiste e kryeministrit Edi Rama dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), fituan shumicën dërrmuese të 61 bashkive të vendit. E majta mundi të marrë 45 bashki. Nën kontrollin e saj kaluan thuajse të gjitha qytetet e mëdha të vendit, me përjashtim të Shkodrës, e cila i mbeti të djathtës.

## Mustafa: Sfidë në Luginë mbeten tekstet shkollore

**PRESHEVË, 5 NËNTOR** - Kreu i Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa, tha se tashmë është zyrtar fitorja për këtë Këshill. Partia për Veprim Demokratik (PVD), sipas tij, jo vetëm se ka treguar se është partia më e madhe në Luginën e Preshevës, por do ta udhëheqë këtë Këshill. "Duhet të kemi bashkëpunim me të gjitha listat garuese për në Këshill, po ashtu jemi të interesuar të kemi përfaqësim të të gjitha listave. Unë i prij listës së PVD-së dhe, krahas kësaj, do t'i



marrim përgjegjësi tona për të udhëhequr Këshillin, por së bashku me listat e tjera dhe t'i kryejmë detyrat në bazë të mundësive që na jepen", tha Mustafa. "Prioritetet tona janë: arsimiti, kultura, informimi dhe përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe. Po ashtu, prioritet mbetet edhe më tej arsimiti dhe ajo që edhe më tej është sfidë e madhe, është sigurimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës si dhe problematikat e tjera që duhet të zgjidhen në këtë mandat", tha Mustafa.

## Ministria e Integritimit nënshkruan memorandum mirëkuptimi me UNDP-në

**PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER)** - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe shefja e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Ulrika Richardson, kanë nënshkruar të hënën një memorandum mirëkuptimi. Nënshkrimi i këtij memorandum ka për qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes çrënjosjes së varfërisë, avancimit të gruas, qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit si dhe më shumë bashkëpunim efektiv për

zhvillim. Me këtë rast ministria Hoxha e ka vlerësuar memorandumun shumë të rëndësishëm, duke pasur përparim në shumë sfera të agjendës sociale të BE-së dhe reformat shtetërore në fushat ekonomike, politike dhe zhvillimore të cilat e drejtojnë Kosovën më afër familjes evropiane. Ndërsa shefja e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Ulrika Richardson, ka theksuar se

nëpërmjet këtij memorandum mirëkuptimi mbështet Ministrinë e Integritimit Evropian në procesin integruar, duke u fokusuar në fusha me interes të përbashkët si zbatimi i MSA-së, Agjenda Evropiane e Reformave dhe reformat e tjera të procesit integruar për një zhvillim të qëndrueshëm. Hoxha dhe Richardsoni kanë vlerësuar lart këtë memorandum i cili fuqizon angazhimin e gjithanshëm të Kosovës për tejkalimin e sfidave në proceset integruar.



Analistët politikë dhe përfaqësuesit e pozitës nuk i shohin zgjedhjet e reja si zgjidhje për situatën aktuale politike në vend

## Zgjedhjet e reja nuk do të prodhojnë asgjë të re

Njohësit e rrethanave politike dhe zyrtarët e pozitës anë shprehur skepticizëm se zgjedhjet e parakohshme do të prodhonin diçka të re në skenën politike. Ata janë shprehur të bindur se zgjedhjet nuk janë zgjidhje për momentin. Zgjidhja më e mirë, sipas tyre, do të ishte arritja e një konsensusi politik ndërmjet pozitës dhe opozitës për disa çështje të rëndësishme kombëtare për vendin

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja është konsideruar legjitime, por analistët politikë dhe përfaqësuesit e pozitës kanë vlerësuar se ato nuk do të sillnin asgjë të re në skenën politike. Sipas tyre, hulumtimet e opinionit publik tregojnë se edhe zgjedhjet e parakohshme do të prodhonin një skenë pothuajse të njëjtë të përçarë në dy blloqe.

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka shprehur skepticizëm rreth mbajtjes së zgjedhjeve të reja. "Zgjedhjet janë gjithnjë të mirëseardhura nëse ato çojnë drejt daljes nga kriza dhe premtojnë rezultatin më deciziv në favor të partive në pushtet ose të atyre në opozitë. Anketat tregojnë se nuk ka lëvizje të mëdha në disponimin e elektoratit dhe se edhe pas zgjedhjeve të reja të parakohshme do ta kemi skenën pothuajse të njëjtë të përçarë në dy blloqe. Jam skeptik se ato mund ta nxjerrin rezultatin me koalicionet e reja

'shpëtimtare'", ka thënë Maliqi për "Epokën e re". Sipas tij, kjo legjislaturë duhet të arrijë një konsensus për dialogun me Serbinë para zgjedhjeve. "Nga ana tjetër, është reale frika se do të na rrëshqasë prej duarsh mundësia që ta finalizojmë dialogun me një marrëveshje historike që sforcon shtetësinë e Kosovës. Për bllokadë gjithnjë do të ketë mundësi nëse marrëveshja, siç thonë skeptikët, do të jetë e disfavorshme. Por çka nëse tani humbin kohë dhe rrethanat ndërkombëtare në ndërkohë e vështirësojnë pozitën e Kosovës dhe atë marrëveshje të synuar që ia siguron Kosovës anëtarësimin në OKB?", ka thënë ai.

Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, është shprehur i bindur se zgjedhjet e reja nuk do ta ndryshonin situatën. Sipas tij, ajo që duhet të ndërrojë është mentaliteti i partive politike. "Edhe 100 herë mund të mbajmë zgjedhje dhe situata do të mbetet po kjo që është. Nuk është bllokuar procesi për shkak të zgjedhjeve,



por për shkak të vetëdijes që e kemi. Ne nuk mund të ndërrojmë brenda natës. Do t'i mbeteshim të njëjtit edhe pas zgjedhjeve. Bile edhe Hashim Thaçi, për të cilin po bëhet gjithë kjo lëmë, do të mbetet president. Kishte një shans që Kuvendi ta disiplinonte, por nuk e bëri. Inshallah po u kthehet mendja e humbur deputetëve dhe po e kuptojnë rëndësinë e këtij procesi", ka thënë Nitaj.

Kurse shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka vlerësuar të paqëndrueshëm qëndrimin e opozitës se institucionet aktuale kanë humbur legjitimitetin. "Në fillim dua të nënvizoj se opozita në çdo kohë ka të drejtë të kërkojë zgjedhje

të parakohshme. Këtë të drejtë nuk mund t'ia mohojë askush. Sa i përket legjitimitetit të Qeverisë, mendoj se nuk kanë të drejtë, sepse si çdo qeveri, edhe kjo Qeveri legjitimitetin e ka marrë nga votimi i shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Rrjedhimisht, derisa Kuvendi nuk vendos ndryshe, qoftë përmes mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, qoftë përmes vetëshpërndarjes së Kuvendit, konstatimi i dy partive opozitare, se Qeveria nuk ka legjitimitet, nuk qëndron!", ka thënë Sherifi. Deri më tani qëndrimet e LDK-së dhe të LV-së për zgjedhje të reja kanë qenë vetëm deklarative. Sipas zyrtarëve të këtyre subjekteve politike, zgjedhjet e reja janë interes

shtetëror. Mirëpo i vetmi subjekt politik opozitar që deri më tani i ka depozituar nënshkrimet për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë është PSD-ja. Zëdhënësja e Partisë Socialdemokrate (PSD), Natyra Kuçi, ka deklaruar për gazetën se Qeveria mund të rrëzohet vetëm me opozitën e bashkuar. "Ne jemi deklaruar dhe kemi pasur veprime konkrete karshi kësaj çështje. Sa i përket mocionit për rrëzim të Qeverisë, ne jemi i vetmi subjekt opozitar që i kemi dhënë nënshkrimet. Por, duhet kuptuar se mundësi serioze për rrëzimin e Qeverisë është vetëm opozita e bashkuar me strategji të përbashkët, e kjo nuk bëhet pa Partinë Socialdemokrate", ka thënë Kuçi.

## Mustafa e Qalaj flasin për objektivat strategjike të sigurisë



PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka vizituar të hënën Policinë e Kosovës, ku është pritur në takim nga drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni, Rashit Qalaj.

Në takimin e udhëhequr nga Qalaj është diskutuar për temat që kanë të bëjnë me realizimin e objektivave strategjike që ndërliken me sigurinë e përgjithshme, ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Po gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për çështje të tjera me prioritet, si: Ligji për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve të

PK-së, Ligji për pagat, mungesën e sigurimeve shëndetësore për PK-në, si dhe çështje të tjera me interes të përbashkët ndërinstitucional. Ministri i MPB-së, Ekrem Mustafa, është informuar nga drejtorët e departamenteve policore mbi angazhimet, punën dhe aktivitetet policore që janë duke kryer këto departamente. Takimi në fjalë ka rezultuar me zotimin e përbashkët për bashkëpunim dhe përkrahje të ndërsjellë, si dhe për angazhime shtesë nga të gjithë të pranishmit, me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve policore të cilat janë në interes të qytetarëve dhe vendit.

Flet për "Epokën e re" kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë, Ragmi Mustafa

# Presim mbështetje më të fuqis



Kryetari i sapozgjedhur i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, ka vlerësuar se kjo fitore e tij tregon se Partia për Veprim Demokratik (PVD) është subjekt i së ardhmes. Ai ka thënë se Këshilli të cilin do ta drejtojë gjatë këtij mandati do të jetë mekanizëm shtesë për realizimin e lirive individuale e kolektive të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka bërë me dije se prioritete do t'i ketë cilësinë në arsim, kulturën, informimin si dhe përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Ai ka thënë se pret mbështetje më të fuqishme nga Kosova dhe Shqipëria si dhe një rol më aktiv të tyre

**EPOKA  
ERE**

**Shqipe HETEMI**

**PRISHTINE, 5 NËNTOR** - Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, të hënën e ka quajtur nder dhe përgjegjësi zgjedhjen në krye të këtij mekanizmi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se do të angazhohet për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave me të cilat përballen shqiptarët në Luginë të Preshevës. Mustafa ka deklaruar se fitorja e tij tregon se Partia për Veprim Demokratik (PVD) është sub-

jekt i së ardhmes. Ai ka bërë me dije se Këshillin të cilin do ta drejtojë gjatë këtij mandati do të jetë mekanizëm shtesë për realizimin e lirive individuale dhe kolektive të shqiptarëve në Luginë.

Mustafa ka treguar se prioritete do t'i ketë cilësinë në arsim, kulturën, informimin si dhe përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për raportet e Luginës së Preshevës me Kosovën dhe Shqipërinë duke thënë se rritja e bashkëpunimit me qeveritë e shteteve shqiptare është esenciale. Në këtë drejtim Mustafa

ka thënë se pret mbështetje më të fuqishme nga Kosova dhe Shqipëria si dhe një rol më aktiv të tyre. Mustafa e ka komentuar edhe idenë për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën për të cilën ka thënë se kërkon shumë punë dhe angazhim për t'u realizuar. "Kjo fillimisht është ambicie e shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Konsideroj se duhet shumë punë dhe një qasje serioze e strategjike ndaj kësaj ideje. Jam i bindur që në rrethanat në të cilat gjendet rajoni duhet të bëhet bashkë i tërë spektri politik në Kosovë

# hme nga Kosova dhe Shqipëria



në Luginë të Preshevës?

**Mustafa:** Është përgjegjësi dhe nder i madh. Besoj se bashkërisht të pamundshmen mund ta bëjmë të mundur dhe në përshatje me ambicjet legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës t'u qasemi zgjidhjeve dhe sfidave që kemi përballë.

**"Epoka e re":** Si e komentoni këtë fitore të Partisë për Veprim Demokratik (PVD)?

**Mustafa:** Më lejoni të theksoj se Partia për Veprim Demokratik (PVD) jo vetëm se është fituese bindëse në këto zgjedhje, por ka treguar se është subjekti më i madh në Luginën e Preshevës si dhe është subjekti politik i së ardhmes. Është përgjegjësi dhe nder i madh.

**"Epoka e re":** Duke qenë drejtues i këtij Këshilli, çfarë do të bëni për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginë?

**Mustafa:** Këtë institucion e konsideroj vetëm si një mekanizëm shtesë që duhet marrë përgjegjësit e veta për realizimin e lirive individuale dhe kolektive të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Do t'i marrim praktikën më të mirë në rajon dhe konform tyre do të kemi një qasje strategjike.

**"Epoka e re":** Cilat do të jenë prioritetet tuaja gjatë këtij mandati?

**Mustafa:** Sigurisht nuk do të ndalemi në kërkimin e zgjidhjeve për mbështetjen e ambicieve legjitime të shqiptarëve, sigurisht edhe për konsumimin e kompetencave që siguron ligji dhe konventat përkatëse. Mbeten prioritetet cilësia në arsim dhe sigurimi i mjeteve bazike për mbarëvajtjen e procesit edukativ-arsimor si dhe fushat jo më pak të rëndësishme si kultura, informimi dhe përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip.

**"Epoka e re":** Çfarë vlerësimi keni për raportet e Kosovës me Luginën e Preshevës?

**Mustafa:** Është esenciale ta rrisim bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Kosovës, institucionet e Shqipërisë dhe jo vetëm. Raportet duhet shtuar përmes projekteve të përbashkëta që duhen implementuar. Pres mbështetje edhe më të fuqishme nga Kosova dhe Shqipëria dhe një rol më aktiv.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, si e komentoni idenë e presidentit Hashim Thaçi për bashkimin e Luginës me Kosovën? Mund të realizohet një ide e tillë në këto

rrethana?

**Mustafa:** Kjo fillimisht është ambicie e shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Konsideroj se duhet shumë punë dhe një qasje serioze e strategjike për këtë ide. Jam i bindur se në rrethanat në

të cilat gjendet rajoni duhet të bëhet bashkë i tërë spektri politik në Kosovë për trajtimin dhe shqyrtimin si çështje e së drejtës historike dhe qasjes pragmatike. Kjo do të ishte një fitore e madhe për Luginën e Preshevës dhe për shqiptarët.

Nuk mund të kemi standarde të dyfishta për trajtimin e pakicave në Ballkan dhe krahasimisht në Kosovë të favorizohet pakica serbe dhe në Serbi të diskriminohen shqiptarët. Andaj duhet shumë punë dhe angazhim për ta realizuar.

## Raportimi financiar në komuna rrit efikasitetin në shpenzim të parasë publike

**PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER)** - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) ka mbajtur sesion diskutimi me temë "Korniza ligjore, ekzekutimi dhe raportimi i buxhetit në nivelin lokal" për ta analizuar situatën aktuale të kornizës së financave lokale e, po ashtu, ekzekutimin, raportimin dhe kontrollin financiar në nivel lokal.

Pjesëmarrës në këtë sesion ishin përfaqësues nga drejtoritë për buxhet dhe financa nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ky sesion lidhej me rëndësinë që komunat ta përmirësojnë planifikimin dhe raportimin financiar në mënyrë që ta arrijnë zhvillimin e qëndrueshëm, duke adresuar edhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Për më tepër, sesioni për synim kishte që përmes shpalosjes së problemeve nga komunat të dalin rekomandime/propozime konkrete për ta lehtësuar dhe përmirësuar procesin e ekzekutimit dhe raportimit financiar. Raportimi financiar është mekanizmi kryesor për

monitorimin e buxhetit të komunës përmes të cilit bëhet informimi mbi ecuritë dhe përmbushjen e planeve të grumbullimit të të hyrave, përmbushjes së obligimeve të planifikuara si dhe mënyrat e shpenzimit të parave sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore.

Në hapje të sesionit drejtori ekzekutiv i Institutit KLGJ, Besnik Muçaj, ka theksuar se një proces buxhetor i integruar mirë rezulton me vendime më të mira financiare, duke ndikuar kështu pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të komunave. Buxheti në qeverisjen lokale paraqet planin financiar, i cili specifikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore. Andaj, përmes procesit buxhetor, institucionet në nivel lokal vlerësojnë nevojat e tyre kundrejt nivelit të buxhetit që kanë në dispozicion.

Drejtori i përgjithshëm i Thesarit, Ahmet Ismaili, ka thënë se në kuadër të përgjegjësisë të Thesarit është edhe kontabiliteti i shtetit si

dhe përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore të ekzekutimit të buxhetit. Të gjitha shpenzimet e buxhetit të shtetit, për organet qendrore dhe lokale, kryhen përmes Drejtorisë së Thesarit të Shtetit përmes sistemit të Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Është e rëndësishme të zbatohet me përpikëri legjislacioni relevant në fushën e financave publike, me qëllim që të evitohen dhe mos të paraqiten rastet kur për realizimin e projekteve nuk ka pasur fonde të mjaftueshme të zotuar.

Gjatë diskutimeve u njoftuan për të rejtat nga Thesari, u morën komentet dhe u adresuan disa sfida të përbashkëta, në raport me përmirësimin e procesit që lidhet me financat lokale. Ky aktivitet është në shtyllën e përmirësimit të ciklit të politikave publike në nivel lokal dhe realizohet në kuadër të projektit në "Mbështetje të Komunave më të Forta dhe më të Qëndrueshme (SSSM)" i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.



për trajtimin dhe shqyrtimin si çështje e së drejtës historike dhe qasjes pragmatike. Kjo do të ishte një fitore e madhe për Luginën e Preshevës dhe për shqiptarët. Nuk mund të kemi standarde të dyfishta për trajtimin e pakicave në Ballkan dhe krahasimisht në Kosovë të favorizohet pakica serbe dhe në Serbi të diskriminohen shqiptarët. Andaj duhet shumë punë e angazhim për ta realizuar", është shprehur Mustafa.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, çfarë do të thotë zgjedhja juaj në krye të Këshillit Kombëtar Shqiptar

# Shukri Buja thotë se dënimi ndaj tij është i orkestruar nga njerëz të politikës

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënua të hënën me tre vjet burgim ish-kryetarin e Komunës së Lipjanit dhe ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, Shukri Buja, nën akuzat për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Buja akuzohej nga prokuroria për keqpërdorim të pozitës zyrtare në lidhje me një memorandum mirëkuptimi të nënshkruar nga Komuna e Lipjanit me kompaninë "NEW Co Feronikel Complex LL. C.". Bashkë me Bujën, të akuzuar në këtë rast ishin edhe nëntë persona të tjerë. Ky gjykim përbën

një nga rastet e shënjestruara edhe nga Bashkimi Evropian në kuadër të kriterëve për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, që ndërlihen me liberalizimin e vizave.

Ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, Shukri Buja, pas shpalljes së aktgjykimit me të cilin ai u dënua me tri vjet burgim për keqpërdorim të detyrës zyrtare në kohën kur e drejtonte Komunën e Lipjanit, shpreson se tashme liberalizimi i vizave të ndodh. "Pas dënimit tim shpresoj të liberalizohen vizat", ka thënë Buja. Ai ka thënë se në këtë vendim ka dorë politika. "Janë njerëzit e politikës që nuk e duan konkurrencën politike", është



shprehur ai, duke mos dashur të përmend emra konkretë për këtë deklaratë.

Komuna e Lipjanit në kohën kur

drejtohej nga Shukri Buja, më 21 mars 2008 kishte nënshkruar memorandum me "NEW Co Feronikel Complex LL. C." për

dhënien me qira kësaj kompanie një ndërtesë të laboratorit në Lipjan. Sipas aktakuzës, në memorandum ishte përcaktuar që "NEW Co Feronikel Complex LL. C." të paguajë nga një euro në muaj qira për objektin e laboratorit, ndërsa kompanisë ky laborator i ishte dhënë për 10 vjet. Prokuroria pretendonte se i është shkaktuar dëm Komunës së Lipjanit lidhur me këtë marrëveshje.

Më 28 prill Buja u deklarua i pafajshëm për akuzat me të cilat ngarkohet.

Ekzekutimi i dënimit ndaj ish-kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja, bëhet pasi vendimi bëhet i plotfuqishëm.

## Ministri Gashi raporton për të arriturat dhe sfidat në MKRS

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rini Gashi, të hënën ka raportuar pranë Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për periudhën janar-tetor 2018.

Ministri Gashi ka thënë se ministria që drejton përmes mekanizmave institucionalë e ligjorë ka vazhduar përbushjen e objektivave të përcaktuara në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, duke krijuar mjedis mbështetës institucional për zhvillimin bashkëkohor të këtyre fushave, duke e promovuar identitetin kulturor, sportiv dhe rininë e Kosovës brenda dhe jashtë vendit. "Në fushën e kulturës janë realizuar premiera të shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Kosovës, Baletit Kombëtar, janë mbajtur koncerte artistike të Filarmonisë, të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve 'Shota', ekspozita të Galerisë Kombëtare të Kosovës



dhe të Galerisë së Ministrisë së Kulturës", ka thënë ai. Po ashtu, Gashi ka bërë me dije se "është rritur buxheti për Qendrën Kinematografike të Kosovës për mbështetjen e projekteve filmike nga 800 mijë euro në vitin 2017 në 1.4 milion në vitin 2018, është përmirësuar infrastruktura ligjore në fushën e kulturës e më konkretisht aprovuar Rregullorja për Pagat dhe Gradat e Krijuesve, Performuesve dhe Punonjësve të Trashëgimisë Kulturore, me të

cilën janë rritur pagat e këtyre kategorive 50 për qind, është miratuar Rregullorja për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me të cilën është zbatuar Ligji për sponsorime në këto fusha, duke përmendur edhe pjesëmarrjen e suksesshme të Kosovës në festivale të ndryshme ndërkombëtare".

Ai ka shtuar se një e arritur e veçantë dhe historike në sek-

torin kulturor dhe atë kreativ është nënshkrimi i marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian për qasje në kuadër të programit evropian Evropa Kreative.

Në fushën e trashëgimisë ministri Gashi ka përmendur themelimin e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore dhe miratimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrotjtje të Përkohshme.

Gashi ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e rinisë ka vazhduar avancimin e kornizës ligjore dhe është në përfundim e sipër strategjia për Rini 2018-2023, si dhe Ligji për Rininë. Ai ka treguar se në kuadër të mbështetjes së organizatave rinore janë mbështetur 134 projekte të organizatave rinore. Ai ka thënë se e arritur e veçantë në fushën e rinisë është krijimi i Fondit Rinor dhe mbështetja financiare për ndërtimin e Qendrës së Edukimit Joformal

për Rini me lokacion në fshatin Pjetërshan në Komunën e Gjakovës dhe janë ndërtuar objektet e qendrave rinore në Pejë dhe Vushtrri.

Ndërkaq për sa i përket fushës së sportit, ministri Gashi ka pohuar se janë ndërmarrë hapa për rregullimin e fushave të rëndësishme ligjore në sport dhe janë nxjerrë aktet nënligjore sipas planit të paraparë. "Gjithashtu, e arritur e veçantë është edhe themelimi Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative", ka theksuar Gashi. Ai ka raportuar para anëtarëve të komisionit edhe për fushën e të drejtave të autorit.

Në fund ministri Gashi ka thënë se sfidat që mbeten për të ardhmen janë bllokimi i llogarive rrjedhëse të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, mungesa e nënkodeve për institucionet vartëse dhe buxheti i vogël i MKRS-së.

## Hoti në Ulqin shpalos Programin Ndërshtetëror për Rininë

Ulqin, 5 nëntor (ER) - Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, i shoqëruar nga zëvendësiministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Azem Guri, të hënën është pritur në takim nga Kryetari i Ulqinit, Loro Nrekiq. Hoti ka prezantuar para Nrekiqit Programin Nacional për Rininë si dhe Programin

Ndërshtetëror për Rininë duke thënë se këto programe janë për të gjithë shqiptarët nga të gjitha trevat. "Programi Nacional për Rininë mund të adaptohet për implementim edhe nga shkollat në Ulqin, por po ashtu mund të bashkëpunojmë në nivelin republikan apo atë ndërshtetëror", ka thënë Hoti.

Ndërsa Nrekiq ka falënderuar Hotin për vizitën dhe për gatish-

mërinë për bashkëpunim. "Ulqini ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me Kosovën andaj jam shumë i lumtur dhe falënderues që sot keni sjell një program për nxënësit dhe studentët. Komuna e Ulqinit është e hapur për bashkëpunime të këtij lloji që janë për të mirën e të rinjve tanë", u shpreh Nrekiq. Në fund të takimit, Hoti i dhuroi kompletin e Programit Nacional për Rininë.



Përkujtohet Astrit Dehari në dyvjetorin e vdekjes

# Edhe pas dy vjetëve ende nuk dihen arsyet e vdekjes së Astrit Deharit

Të hënën është përkujtuar aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, i cili më 5 nëntor të vitit 2016 kishte vdekur në qendrën e paraburgimit në Prizren në rrethana ende të paqarta. As pas dy vjetësh nuk ka ende përfundim të hetimeve për vdekjen e tij. "Në shtetin e kapur, burgjet janë fronte. Aty na e mbytën Astritin. Dy vjet më vonë ne kemi dhembje, sepse nuk e kemi Astritin dhe sepse nuk e kemi drejtësinë", ka thënë lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Të hënën janë bërë dy vjet nga vdekja e aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, i cili më 5 nëntor të vitit 2016 kishte vdekur në qendrën e paraburgimit në Prizren në rrethana ende të paqarta. Për nder të jetës dhe veprës së Astritit një delegacion i Lëvizjes, i prirë nga kryetari Albin Kurti, së bashku me shumë aktivistë, kanë bërë homazhe pranë varrit të tij. "Në shtetin e kapur burgjet janë fronte. Aty na e mbytën

Astritin. Dy vjet më vonë ne kemi dhembje, sepse nuk e kemi Astritin dhe sepse nuk e kemi drejtësinë. Kur njeriu i drejtë e për drejtësi mbytet, krimi bëhet i pamatshëm. Ky krim nuk mund të falet sepse nuk mund të harrohet. Nuk mund të harrohet sepse nuk mund të falet. Drejtësia për Astritin është liria në Republikë, për qytetarin aktiv, pa të cilën nuk ka republikë dhe as qytetari. Prangat në duart e Astritit dje, sot janë zinxhir i policisë e i prokurorisë, i gjyqësisë e i Qeverisë, në duart dhe këmbët e qytetarit. Drejtësia për Astritin në Kosovë është vetë



liria për qytetarin në republikë. Astrit ishte i Lëvizjes, tash ne jemi të tij", ka thënë në fjalën e tij Albin Kurti.

Ndërsa babai i Astritit, Avni

Dehari, duke i falënderuar të pranishmit, ka thënë se pjesëmarrja dhe protesta i bënë ata edhe më të fuqishëm.

Tomë Gashi, avokat i familjes

Dehari, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se as pa dy vjetësh nuk ka rezultate të hetimeve të pavarura, ndërsa ka parashtuar pyetjen nëse ndonjëherë do të zbulohen vrasësit e Astrit Deharit. "As pas dy vjetësh nuk kemi ende përfundim të hetimeve për vrasjen e Astrit Deharit dhe as rezultate të hetimeve të pavarura, e në kuadër të këtyre hetimeve edhe ekspertiza nga Instituti i Qendrës Universitare të Mjekësisë Ligjore në Lausanne të Zvicrës. A do të zbulohen ndonjëherë vrasësit e Astrit Deharit?!", ka shkruar Gashi.



## Një rrugë në kryeqytet merr emrin Arbënor dhe Astrit Deharit

Me propozimin e grupit të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin Komunal të Prishtinës është vendosur që një rrugë ta mbajë emrin e aktivistëve Arbënor dhe Astrit Dehari për

nder të jetës dhe veprës së tyre atdhetare. Në vendin ku gërrshetohen rrugët "Muharrem Fejza" dhe "Bahri Fazliu" është vendosur dhe ajo e "Arbënor e Astrit Dehari".

# IKD-ja kërkon trajtim me prioritet të rastit për Astrit Deharin

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka shprehur shqetësimin e thellë se, edhe pse kanë kaluar dy vjet nga vdekja e dyshimtë e të ndjerit Astrit Dehari, në institucion korrektues, fatkeqësisht institucionet e drejtësisë ende nuk kanë një përgjigje zyrtare lidhur me këtë rast. "Moszbardhja e rastit Dehari, i cili para dy vjetësh ka vdekur në institucionin korrektues, derisa po mbahej nën masën e paraburgimit, dëshmon për papërgjegjësi dhe koordinim joprofesional në mes të institucioneve vendore, të cilat, në vend se të ndërmarrin veprime konkrete për zbardhjen e rastit, kanë luajtur rol të gabueshëm në publik, duke u bërë pjesë e

luftërave politike", është thënë në komunikatën e IKD-së. Sipas IKD-së, në çdo shtet demokratik duhet të aplikohen standardet minimale të kujdesit të personave që janë të privuar nga liria si rezultat i procedurave gjyqësore. "Siguria dhe kujdesi i personave të arrestuar/paraburgosur apo atyre që janë në vuajtje të dënimit në institucione korrektuese apo qendra të paraburgimit është drejtpërdrejt obligim dhe përgjegjësi e shtetit. IKD-ja vlerëson se mënyra e trajtimit të rastit Dehari, prej momentit të vdekjes së tij të dyshimtë, ka qenë krejtësisht e gabuar, duke interpretuar secilin veprim dhe mosveprim zyrtarët e institu-



cioneve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera në kundërshtim me obligimet ligjore. Trajtimi joprofesional i rastit prej momentit të vdekjes ka rënduar situatën në tërësi, duke vështirësuar hetimin e

drejtë, të pavarur dhe të paanshëm. Fatkeqësisht, një qasje e tillë ende është duke vazhduar, ku lidhur me këtë rast është krijuar amulli, përderisa familja dhe publiku ende nuk kanë një përgjigje zyrtare dhe të bazuar

në fakte dhe prova të besueshme", është thënë në këtë komunikatë.

IKD-ja u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse të zhvillojnë hetime të pavarura dhe adekuate që përmes mbledhjes së provave dhe dëshmiave të përcaktohet përgjegjësia e zyrtarëve, të cilët, qoftë për shkak të neglizhencës, dashjes, veprimit apo mosveprimit, kanë lejuar të vijë deri te vdekja e dyshimtë e Astrit Deharit. "Rasti Dehari duhet të trajtohet me prioritet dhe institucionet shtetërore duhet të kenë në dispozicion të gjitha resurset e nevojshme për zbardhjen sa më të shpejtë të këtij rasti", është theksuar në komunikatën e IKD-së.

# Rukiqi: Të fokusohemi te sektori privat dhe zhvillimi i tregut

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë të hënën se dominimi i agjendës politike ka lënë në hije zhvillimet ekonomike. Sipas tij, bllokimi i punës së Kuvendit është duke e bllokuar edhe ambientin e biznesit dhe kjo situatë nuk po tërheq investitorët



heshin", është shprehur Rukiqi. Ai e ka vlerësuar të padrejtë për gjeneratat e reja dhënien e pagesës për mësimdhënësit e viteve '90 pasi, sipas tij, ato para mund të shkojnë në zhvillim ekonomik. "Nuk mund të

mohohet kontributi i mësimdhënësve, mirëpo gjeneratat e reja pësojnë sepse ato para duhet të shkojnë në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e vendeve të reja të punës", ka deklaruar Rukiqi. Ai ka folur edhe për importin e

veturave dhe standardin EURO 4. "Temë tjetër është edhe çështja e vjetërsisë së importit të veturave. Ne duhet t'i plotësojmë standardet ndërkombëtare. Kërkesa jonë është për versionin që e plotëson kriterin EURO4 të jetë kriter për importim të veturave", ka thënë ai. Ai ka thënë se Oda Ekonomike nuk do të lëshojë pe sa iu përket kontratave kolektive derisa të nivelizohen të drejtat e punëtorëve dhe punëdhënësve.

Duke folur për buxhetin për vitin 2019, Rukiqi ka theksuar se mbetet shqetësuese rritja e skemave sociale. Sipas tij, prej 400 milionë eurove të cilat janë ndarë për këto skema, vetëm me 100 milionë euro do të mund të krijoheshin mbi 20 mijë vend të reja të punës. Ai ka folur edhe për ndëshkimet dhe kamatat që po u bëhen bizneseve nga ana e ATK-së. "Ndëshkimet që janë bërë nga ATK-ja kanë qenë dekurajuese, pasi tek ne fillimisht shikohet të dënohet biznesi, më pastaj u jepen këshilla. Po ashtu, sa iu përket rasteve të përmbarueseve ka pasur biznese që s'kanë mundur të kryejnë transferime ndërkombëtare për shkak të mbylljes së xhirrollogarive. Për bizneset duhet të gjenden masa stimuluese", ka thënë Rukiqi.

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka mbajtur të hënën konferencë për media, në të cilën ka folur për sfidat dhe shqetësimet e bizneseve në vend. Me këtë rast, ai ka thënë se dominimi i agjendës politike ka lënë në hije zhvillimet ekonomike. Sipas tij, bllokimi i punës së Kuvendit është duke e bllokuar edhe ambientin e biznesit dhe kjo situatë nuk po tërheq investitorët. Rukiqi ka theksuar se problem tjetër janë edhe ligjet që kanë mbetur në procedurë. "Për neve mbetet shqetësuese se Kuvendi nuk po funksionon. Kjo pastaj ka implikime edhe tek investitorët, sepse ata vazhdimisht po theksojnë faktin e një rreziku të lartë politik të mjedisit biznesor",

është shprehur ai.

Kryetari i OEK-ut ka folur edhe për rritjen e buxhetit në Ministrinë e Arsimit, duke pohuar se ky buxhet do të duhej të orientohej në përgatitjen e kadrove për tregun e punës. "Inkurajuese është rritja e buxhetit për arsim dhe shëndetësi, sidomos për buxhetin për arsim. Mirëpo kemi hendek të madh në përgatitjen e kadrove për atë se çfarë kërkon tregu i punës. Është koha e fundit që aktorët e politikave zhvillimore, sektori privat dhe aktorët e zhvillimit të politikave arsimore, të ulen dhe të gjejnë atë çfarë kemi nevojë. Rritja e buxhetit për arsim duhet të përcillet me reformë dhe me rritje të efikasitetit, ndërkaq problematike mbetet skema sociale. Nëse 100 milionë euro nga skema sociale do të investoheshin në krijimin e vendeve të punës atëherë ato do të arsyeto-

## KRU 'Prishtina' dhe Posta thellojnë bashkëpunimin



PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Përfaqësuesit e Postës së Kosovës janë takuar të hënën me zyrtarë të lartë të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. Në këtë takim, i cili është mbajtur në zyrat e KRU "Prishtina", të pranishëm kanë qenë kryeshefi ekzekutiv i kësaj kompanie, Ilir Avdullahu, zyrtari kryesor finan-

ciar Sokol Duraku, kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, zyrtari kryesor financiar i Postës, Behxhet Maliqi dhe drejtori i Departamentit të Shitjes, Bashkim Mustafa. Gjatë këtij takimi është biseduar për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve për konsumatorët të cilët janë pjesë e pandashme dhe

shumë e rëndësishme për të dyja ndërmarrjet publike. Me qëllim të bashkëpunimit më të madh dhe me qëllim të përkrahjes së Postës së Kosovës, zyrtari kryesor financiar në KRU "Prishtina", Sokol Duraku, ka thënë se kjo kompani është e gatshme ta përkrahë Postën e Kosovës. Ai ka thënë se kanë

marrë vendim të përbashkët që në faturat e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të nxirret llogaria e Postës së Kosovës, me qëllim të lehtësimit të pagesave konsumatorëve. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Ilir Avdullahu, dhe ai i Postës, Sejdi Hoxha, kanë thënë se janë të gatshëm ta zgjerojnë

fushën e bashkëpunimit në mes të këtyre dy kompanive. "Do të jemi të gatshëm ta zgjerojmë bashkëpunimin edhe në fusha të tjera në mënyrë që qytetarëve tanë t'u ofrojmë shërbime sa më afër vendbanimeve të tyre dhe të njëjtat të jenë sa më efikase", kanë thënë Avdullahu dhe Hoxha.





# KFOR-i gjerman dhuron pajisje dhe teknologji në vlerë prej dy milionë eurosh

KFOR-i gjerman ka dhuruar pajisje dhe teknologji në vlerë prej dy milionë eurosh për Kosovën për t'i përdorur në parkun e inovacionit në qytetin e Prizrenit

**PRIZREN, 5 NËNTOR (ER)** - "Politika e politikanët vijnë e shkojnë, por popujt jetojnë. Kur popujt kanë lidhje të shtrira të familjet, miqësi e dashuri, ajo jeton më gjatë. Besoj se ne sot jemi duke krijuar një bazë të fortë të një miqësie Kosovë-Gjermani", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj pas vizitës që i ka bërë të hënën kampit të KFOR-it ushtarak gjerman në Prizren, tani me vendim të Qeverisë i shndërruar në Park Inovativ Trajnues Kosovë-Gjerman. KFOR-i gjerman ka dhuruar pajisje dhe teknologji në vlerë

prej dy milionë eurosh për Kosovën për t'i përdorur në parkun e inovacionit në qytetin e Prizrenit. Për ta dëshmuar se Qeveria e Kosovës e ka marrë me përkushtim angazhimin në këtë projekt, Haradinaj ka thënë se do të vazhdojë ta ketë prioritet të saj. Haradinaj bashkë me delegacionin që kishte me vete edhe përfaqësues nga institucione të tjera dhe GIZ-in gjerman, panë nga afër të gjitha resurset infrastrukturore që ofron ky kamp dhe të cilat tani do të jenë pjesë e kampit të ri dhe të gatshme për t'i pritur investitorët e huaj.

"Janë rreth 60 objekte të natyrave të ndryshme dhe të madhësive të ndryshme që kapin vlerën prej 40 milionë eurove të investuara nga shteti gjerman dhe të cilat tani po i trashëgon Kosova dhe projekti i Parkut Inovativ dhe Trajnues", ka theksuar Haradinaj, duke shtuar se një punë e filluar shumë më herët ka arritur në fazën finale dhe për këtë ka falënderuar popullin gjerman, Bundesverin për një qasje të dobishme për Kosovën. Duke i uruar mirëseardhje kryeministrit Haradinaj dhe ministrave në kampin ushtarak, komandanti i kontingjentit gjerman të KFOR-it, nënkolonel Eric Offerman, ka thënë se prania 19-vjeçare e Bundesverit në Prizren është duke marrë fund. Po ashtu,

komandanti Offerman ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pjesëmarrje në parakalimin lamtumirës të trupave ushtarake gjermane, më 4 tetor në Sheshin "Shadërvan". "Gëzohemi që edhe më tej do të jemi pjesë e KFOR-it në Prishtinë dhe do të kontribuojmë për ndërtimin e FSK-së. Në këtë kamp ushtarak të krijuar gjatë 19 vjetëve, Gjermania ka investuar më se 40 milionë euro. Në muajin e ardhshëm do të jemi gati që këta 40 hektarë t'i dorëzojmë Qeverisë së Kosovës. E vetnja gjë që do të na përkujtojë misionin e Bundesverit këtu, do të jetë kjo shtëpizë historike e rojës prapa meje. Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ me vendosmëri do ta përcjellë krijimin e "Parkut të

Trajnimit dhe Inovacionit" në Prizren", ka thënë nënkoloneli Eric Offerman, duke theksuar se infrastruktura në kampin ushtarak në Prizren ofron mundësi të mira për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit dhe të Kosovës. Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka thënë se i kujtohet dita e parë me kryeministrin Haradinaj kur ky projekt ka qenë vetëm në letër dhe se tash po i afrohet realizmit të tij. Të pranishëm në këtë vizitë ishin ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe Dardan Gashi, ministri Bedri Hamza, Valdrin Llluka, Shyqiri Bytyqi, Mahir Jagxhilar, Besim Beqaj dhe Endrit Shala.

## MTI-ja ndalon shitjen dhe shërbimin e alkoolit dhe duhanit për të miturit

**PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në vazhden e vendimeve për mbrojtjen e konsumatorit, të hënën ka lëshuar urdhëresë për Inspektoratin e Tregut, që obligon zbatimin me përpikëri të nenit 15 të Ligjit Nr.

06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Urdhëresa e ministrit Shala ka për qëllim të ndalojë dhe sanksionojë shitjen, shërbimin dhe dhurimin e duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën moshën 18 vjeç. Kjo urdhëresë obligon të gjitha

bizneset që ta paraqesin në vendin e tyre shenjën për ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën 18 vjeç. Në urdhëresë thuhet se të gjitha pikat shitëse do të ndëshkohen në rast të moszbatimit të ligjit.



## Nxënësit e Prizrenit, aktivitete për pastrimin e ambientit

PRIZREN, 5 NËNTOR (ER) - Komuna e Prizrenit, krahas aktiviteteve në klasë për ngritjen e vetëdijesimit të nxënësve për mbrojtjen e ambientit dhe reciklimin e mbeturinave, është duke zhvilluar edhe aktivitete në terren, ku me anë të pastrimit të mbeturinave përreth shkollave po dëshmojnë rëndësia që duhet t'i

kushtohet ruajtjes së mjedisit. Sipas kësaj komune, aktiviteteve tilla janë duke u organizuar në shkollat "Haziz Tolaj", "Mustafa Bakiu" dhe "Abdyl Frashëri", në kuadër të projektit të përmbashkët të Komunes së Prizrenit, Zyres Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe organizatës GAC.



## Begaj takohet me përfaqësuesit e KFOR-it italian

MALISHEVË, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunes së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në një takim pune përfaqësuesit e KFOR-it italian, përkatësisht njësinë e CIMIC-it, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme të bashkëpunimit në mes të KFOR-it italian dhe Komunes

së Malishevës, bashkëpunim i cili është vlerësuar lart. Kryetari Begaj ka falënderuar për bashkëpunimin e mirë dhe për kontributin e KFOR-it në vazhdimësi, e në veçanti të KFOR-it italian, i cili në vazhdimësi e ka përkrahur Komunën e Malishevës. Edhe shefi i njësisë së CIMIC-it,

pjesë e KFOR-it italian në Kosovë, Andrea Vazzaz, e ka falënderuar kryetarin e Komunes së Malishevës, Ragip Begaj, për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in italian, si dhe e ka vlerësuar lart këtë bashkëpunim, i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



POLICE LINE DO NOT CROSS

## Grabitje e armatosur në një filiale të bankës në 'Veternik', lëndohet një person

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se sot në lagjen "Veternik" në Prishtinë ka ndodhur një grabitje e armatosur në filialin e një banke. Përmes një komunikate për medie policia ka njoftuar se grabitja është realizuar nën kërcënimin e armëve, ku tre persona të maskuar kanë sulmuar fizikisht një nga zyrtarët e bankës. "Mbështetur në rezultatet e para të grupit hetimor që po zhvillon hetimet lidhur me rastin në fjalë, dyshohet se kjo grabitje është realizuar nën kërcënimin e armëve, ku tre persona të maskuar kanë sulmuar fizikisht një nga zyrtarët e bankës. "Mbështetur në rezultatet e para të grupit hetimor që po zhvillon hetimet lidhur me rastin në fjalë, dyshohet se kjo grabitje është realizuar nën kërcënimin e armëve, ku tre persona të maskuar kanë sulmuar fizikisht një nga zyrtarët e bankës.

Prishtinë, ka në fokusin e përditshëm të punës së saj luftën kundër krimit, kapjen dhe arrestimin e të dyshuarve të akteve kriminale si dhe garantimin e rendit, sigurisë dhe qetësisë publike, andaj ftojmë të gjithë qytetarët të cilët kanë informacione lidhur me rastet kriminale, e veçanërisht për rastin e sipërhënuar, ta mbështesin policinë me informacionet e tyre për hetimin dhe zbulimin e akteve të tilla", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Prishtinë, ka në fokusin e përditshëm të punës së saj luftën kundër krimit, kapjen dhe arrestimin e të dyshuarve të akteve kriminale si dhe garantimin e rendit, sigurisë dhe qetësisë publike, andaj ftojmë të gjithë qytetarët të cilët kanë informacione lidhur me rastet kriminale, e veçanërisht për rastin e sipërhënuar, ta mbështesin policinë me informacionet e tyre për hetimin dhe zbulimin e akteve të tilla", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.

## Asfaltohet rruga 'Filip Shiroka' në Ferizaj

FERIZAJ, 5 NËNTOR (ER) - Të hënën ka filluar të bëhet asfaltimi i rrugës "Filip Shiroka", në kuadër të asfaltimit të rrugicave të qytetit të Ferizajit. Nga afër punimet në këtë rrugë i ka përcjellë edhe kryetari i Komunes së Ferizajt, Agim Aliu, së bashku me drejtorin e Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, por edhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Me këtë rast drejtori i infrastrukturës, Arbër Bytyqi, këtë projekt e ka cilësuar të një rëndësie tejtejt madhe. "Jemi në zonën urbane të Ferizajt, jemi në muajin nëntor, por kushtet e mira atmosferike na

kanë mundësuar vazhdimin e asfaltimit të shumë projekteve që janë të komunës sonë. Sot po bëjmë fazën e fundit të asfaltimit të kësaj rrugë e cila ka një gjatësi mbi një kilometër, ndërsa ka një kosto prej 50 mijë eurosh", është shprehur Bytyqi. Ndërsa banorët e rrugës "Filip Shiroka" kanë falënderuar kryetarin Aliu dhe Komunën e Ferizajt për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës së tyre.

Është bërë me dije se edhe në ditët në vazhdim do të ketë asfaltim të rrugëve të ndryshme të cilat janë të gatshme për t'u asfaltuar.



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /14/

# Rifat Krasniqi, Basri Sallko, Hasan Rustemi dhe Maliq Balija para prokurorit



Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Nuk e di nese ka marr pjesë në ndonji politik por ai e kundërshtonte okupatorin edhe për këtë shkak ka qenë i internuem në Itali dhe si e kanë lirue kur ishte okupatori gjerman ka ardhur këtu a ne Shkodër, mua me ka pas thënë se jam kundra Jugosllavisë së vjetër dhe duhet me luftue kundra okupatorit dhe bile ka ardhë me marrëveshje dhe ka bisedue me Mehmet Hoxhën që atëherë ndodheshe ilegal si shokët e tij nuk di se cilet ka pas por kam pamun dhe Qazim Bllacën që shkante nganjihere atje, ky thoshte duhet me luftue kundra okupatorit per me mujt me rregullue Kosovën. Ky ka pas folë edhe me Xhavit Nimanin, Ejup Binakun ka bisedue edhe me Sylejman Rізën e kanë qenë në rrethin e Gjakovës me gjasht-shtatë veta, për me i mbajtur ata në mal, mund ti ket que nga ndonji herë ndihma dhe bile mua njëherë ka pas kerkue nji zjet napolona, dhe mund të ket kerkue dhe në vende tjera mbasi ai vet nuk kishte. Ejupi me ka thënë se bënte propagandë per mos me que vullnetar dhe Eses në Shqipëri por ka bamun ndonjë send te tillë ose jo nuk e di. Ndejta e Ejupit në mal nuk me duket pune e mirë per pa u bashkue me radhet partizane, pse Szlejmani kur u pa me Mehmet Hoxhën dhe Xhavit Nimanin se perse nuk u bashkue nuk e di.

Nuk di a ka Ejupi shokë me veti por vetem kam parë në rrethet e Gjakovës, me një oficer anglez. Qazim Bllacën e njohi dhe me te e me shokë kam bisedue ke Sylejman Riza, në shtëpi. Haki Tahën nuk e di nese ka lidhje me Sylejman Rizen ose jo. Pranoj se kur Gjyqëtar i Mborja me ka kerkue shenime, nuk i kam tregue dhe per kete kam gabuar, nuk është e vertet ky te me kishte thene qe te shkoi në Kukës. Nga Tirana jam kthyer në Kukës, në muajin maj dhe në atë kohë i kam que fjalë Tahirit, qe me kishte porosit me i gjetë vend, dhe i kam thanë se he per he nuk ka vend në Kukës dhe se mire je atje se kam degjuar se dhe rrogat po paguhen, kete lajm ja kam que me Hasan Remen, qe vinte nga Prizreni, dhe here te tjera Tahiri nuk i kam que ndonji fjalë. Mua në Tiranë me ka thene

Mehmet Hoxha se se ishim shkarkuar nga detyra e kryetarit te këshillit të Rrethit. Unë sikur se thash Tahirit nuk i kam que fjalë tjetër veç asaj që tregova por nese do te i ketë thene fjalë te tjera Hasani ati i ka thënë vete nga goja e vet, dhe mohon ate qe ne Shqipni do te rrotullohet puna tjera. Hasani kur ishte kthyer nga Prizreni jam pa por skam biseduar me te., punë të tjera dhe se per kete punë. Mohon që Tahiri ti ket thënë per mbledhjen e shenimeve tjera. Dhe thotë se ato munt t'ja kete thënë Hasani vet. Une me Mborjen jam takue per te paren herë ketu ne Prizren i cili sikur se kam thene me ka thene se ashte fis me Agjah Libohoven ish Prokurorin e Kukësit, por me te kam biseduar dhe jo që i kam dhene ndonji shenim, dhe as nuk me ka kerkuar, por vetem me ka pyetur per vrasjen e Hoxhës, unë i kam thënë se kete mundetme i kerkue Qeverija vetë.

**Basri Sallko deklaronte:** Kur u pyet i pandehuri Basri Sallko rreth akuzës qe i bëhet thase une emër të fshehur nuk kam une këtu në Prizren kam ardhur teta dita përpara Ahmet Efendis dhe kur ka ardhur Ahmet Efendija, une te nesërmen jam nisur per Drenicë. Kur kam ardhur këtu jam parë me Tahir Dedën, kete e di si të partisë komuniste. Tahiri me ka pyetur kur ka ardhur dhe kështu e kemi lanë me u takue me te per te biseduar ne medrese, kur jam takue me Tahirin me ka thanë se Hasan Rustemi se po te lyp Tahiri, atje ne medrese Tahiri me ka thënë se ti duhet të vish në organizaten t'onë qe bazen e kemi me rrethin e Kukësit, dhe anglezët do të na ndihmojn por kemi lidhje me Muharrem Bajraktarin, dhe unë tue marr parasysh gjitha këto qe me tha mu mbush mendja dhe hyna në këtë punë. Ndihma më tha Tahiri se i kemi në rrethin e Kukësit dhe me ka thanë se ty ke ke me formue në Ferizaj komitet. Për Halim Spahin nuk me ka thanë gja se është ne parti ose jo. Pastaj jam takue dhe një herë në shtëpin e një mikut te tij qe une nuk e di. Për te punue me tha perme krijue organizatë ne Ferizaj e nepër katunde dhe me pasun mbledhje ne Kaçanik e Gilan, mbasi të bajshim organizatën me u mar vesh me të malit per me mos me ba gja pa ardhur urdhëri prej Prizrenit. Ismail Goranin e njomi i cili ka punue me okupatorin dhe të tjerët qe janë ne mal posi këta janë. Qëllimi jem ka qenë per me shkue e me gjetë ata njerëz bajne të kqija ne Ferizaj e në vende të tjera mbasi kisha per qellim per me i zbulue. Une s'kam punue fare vetem se kam mare shenime e pas 10 ditëve jam arrestue tue bamun asnjë veprim. S'kam kallzue ne pushtet se kam dasht per me zbulue e me gjetë

koritat e malit dhe me i zanë. Tahiri me ka thanë se Ibrahim Budakova asht korili i jem dhe ai e kishte emnin dmth. Tahiri (Une), me te malit s'kam takue se s'kam pas vakt mbasi u arrestova shpejt. Për Ahmet Efendi nune i kam thanë Tahirit qe kur te vij ky ketu bene mirë me takue me te Hasanin, Une e Tahiri kemi qenë me një shtëpi te një akrobaje te Tahirit, une kamshkrue me një copë leter ate qe me diktonte Tahiri e mandej mbasi u merzit Tahiri e la dhe e grisit e të nesërmen Tahiri me dha tri copa letra të cilat i kam kendue dhe i kam fshehur ne shtëpi, e më vonë ja dorëzova Oznes, pa mi kerkuekur me arrestoi. Ante Vujoviqin nuk e njof, me te ne burg kam folur por jo çështje politike e të tjera qe me thoni, por per Kral Petrin mund të kemi folë, mua më kanë thënë se me Drazhista s'kemi me punue, por se si do të punofshim kete nuk e di. Instruksionet qe kam pas, i kam kënduar dhe kam dijt rendesin e tyre. Tahiri me ka thënë se mbasi te lidhem çka do të duhet ke me kerkue se kemi me ti dergje se kemi ndihmen e anglezve dhe kolla Kuksit kane qitë një bukë të madhe prej arit. Mbi pyetjen e paraqitësit mbrojtës te Ibrahim Abdylit i pandehuri tha , unë Ibrahimin nuk e kam pare fare.

Kryetari i gjyqit urdhëroi qe te behen 10 minuta pushim. Mbas kalimit të dhjetë minutave filloi gjyqi rishtazi si më parë.


**Hasan Rustemi deklaronte:** Kur u pyet i pandehuri Hasan Rustemi rreth akuzës qe i bahet tha se: Un tjetër emër veq Hasan Rustemi nuk kam. Unë kam qenë nëpunës i Këshillit të Rrethit të retushem, unë në organizatë skam marr pjesë fare, vetem se jam takue me Basri Sallken dhe kemi qenë në shtëpi t'ime i cili ka folë me Tahirin, unë kam qenë prezent dhe keto fjale i kam ndegjue dhe kam gabue qe s'kam kallzue ne pushtetin popullor. Basrin e ka ngreh Tahir Deda vetem se pjekja asht bamun ne shtëpin time, mbasi unë Basrin e kam kusheri te gras. Me Tahirin jemi takue njihere ne shtëpin time. Tahiri ka thanë te flasi lirisht se Hasanin e kemi besnik, ne kete rast asht verdhe ne fytyrë. Kur kane biseduar aty Tahiri thot se, neve ketu kemi formue një organizatë e jemi mar vesh me Rahovecino tri kater ditë, kur Basrija tha se skemi çar me ba, Tahiri i tha se kemi lidhje e marrveshje me Shqipnin e me Kukësin e si kanë bisedue ma ne fund Tahiri i thotë Hasanit se me ne shtëpin e Hasanit nuk mund të takohemi, po ashtu kanë biseduar se kanë bashkim dhe me Muharrem Bajraktarin, bile Tahiri ka thanë se si ka shkue ne rrethin e Durrësit, pra i thotë Basrisë qe duhet me formue një organizatë te

vogël edhe me u mar vesh me të arratisurit e malit e ti thoni se te mos bahet ndonji send deri sa sju vine urdhëra neve prej Shqipërisë, e juve prej nesh. Këjo natyrisht ishte kundra qeverisë të Enver Hoxhës se keto dhjetë ditë thonte Tahiri pritet të bahet atje diçka, edhe Tahiri thonte se kemi lidhje me Kukës, Kukësi me Shqipënin e Shqipnija me Barin e Italisë ku atje janë anglezët per te holla e ndihma skam ndegjue. Tahiri kallëzonte se drazhista ka shumë në mal e duhet me u marr vesh me ta te malit se dhe une i kam que fjalë se mos me u marr vesh me drazhista, po keshtu Tahiri ka thanë edhe kete se per poste duhet të gjeni njerëz të mirë dhe në rast mungese duhet me perdor grate edhe se kur te rrotullohet puna me Shqipni atëherë do të bejm neve ndërhyrje. Basrija në shtëpin teme i ka tregue emnin e korilit Tahirit e Tahiri e ka shenje ne një liste. Ky koril do te dergonte emnat e listat e të vrarëve per me ja paraqit Englezve kur të vijoshin këtu. Basrija kur ka ardhur ketu me ka thënë se mos mu huqë përgjegjësia e Gilanit, se Tahiri u muer vesh me hoxhët që ndodhen keru për konferencë dhe me mbetet per te formue vetem Ferizai. Për poste Tahiri se jemi në rregull e se çdo mbrëmje marrim poste.

U muer për ballafaqim Basri Sallkuja me të pandehurin Hasan Rustemin si u pyet Basriu tha se per poste me ka thanë se vjen, per hoxhe eshte e vertet se këtë i kam thane po per poste me ka thanë se per Gilanin e Kaçanikun i kam thanë se u shkarkua e mbasi Tahiri do te merret vesh me hoxha per me formua komitet. Për parullat Tahiri ka thanë se kanë me na ardhur nga Kukësi dhe kolla Kukësit prej Muharrem Bajraktarit te cilat mendoi kishte me na i que neve. Kushdo e jepte urdhërin nuk e di, pasi e kam marr vesh ky do te epesh me anen e një aeroplani qe do te nxirrte tym e atëherë punet ishin në rregull. Tahirit une emër të korilit nuk i kam dhanë dhe lista qe i donte kishte me mbetun ke unë. Kur u pyet i pandehuri Hasan tha se une s'kam shkru me makin gjë, por Tahiri do ket shkru.

**Maliq Balija deklaronte:** Kur u pyet i pandehuri Maliq Balija rreth akuzës qe i bahet i cili tha se: Emer tjetër veç emrit të vertet Maliq Balija nuk kam. Tokë e gje në Rahovec nuk kam e as hoxhë i atij katundi nuk jam por per çdo ditë pazari shkojë në katundin Rahovec ku blej ve e tjera mbasi une merrem me tregti. Para një jave para se të arrestohem kam marr vesh se në Prizren ka një komitet. Unë kam shkue një muaj para arrestimit në Rahovec per me u pa me Kadri Minushin mbi fjalën e Tahir Dedës, e mbi fjalën e Tahirit i kam thanë atij se duhet me formue një komitet e me

mbledhë shenimet per te vramit e se dyti kur Tahiri deshte me me que unë skam shkue. Minushi me ka kallzue se ka qenë nji komitet me parë atje e me kalljo se kam frikë se mos meret vesh. Tahir me ka pas dhanë një leter, heren e dytë per me ja que Kadri Minushit e une i mora vesh keto punë se eshte e keqe e kam shkue dhe kjo ka qenë mrena kater ditëve te burgimit, mbasi Tahiri kur ma dha letren me tha "shife se po u mur vesh kjo punë njeni ose tjetri kete punë vrite. Une s'kam thanë gjë për çështjen e Shqipnisë, por per Jugosllavi me ka pas thanë Tahiri se në Beograd do te bahet një kryengritjee do të rrotullohen punët. Unë s'kam marr pjesë në komitet, Kadriu me ka thanë se kur të mbajm mbledhje te jesh edhe ti, por unë nuk vajta. Sadik Peqnin e njohi edhe me te jam taku ne rrugë dhe mbasi jemi fjalos me ka thanë se ka qenë ke Tahiri bashk me Qamil Eminin dhe nuk kanë pranuar se i ka ngarkue Tahiri. Tahiri me ka thanë se neve ne Shqipni kemi një gjyqëtar qe majm korrespondencë dhe ky gjyqëtar ka kohë qe ka qenë këtu. Kadri Minushi me ka pas thanë se Ahmet Dërguti ka dasht me e vra Nikolla Vidaqiqin për hakmarrje, por na nuk e kemi lanë. Dërgutit iu ka pas vra një vëlla me ardhjen e partizanëve. Veç Tahirit me mue ska pas lidhje tjetër kush. Emnat e fsheht qe ka pas Kadrija e Tahiri e të tjerët nuk i di. Unë kurr ndonjëherë s'kam qenë marr me politik, dhe për këtë nuk kam lajmruë Qeverin dhe kete e ndiej si gabim. Për një punë të ballistave qe kam pas marr vesh, kam pas lajmruë Riza Shehdullen që ndodhet në OZN-e mbasi kisha marr vesh se ballistat janë afrue në katundin Hoqë, dhe vendin ku kanë marr bukë e drithë mbasi kamë pas frikë se mos me bahet ndonji send si u ba në Drenicë, por Rізaja nuk bani ndonji send dhe keshtu edhe për kete ky ka qenë shkaku qe nuk lajmrova se nuk do të bahesh ndonji send. Fehim Ibrahimin nuk e kam pas njoh me parë, veçse tash ne burg. Hoxhollaret kur kanë ardhur ketu per konferencë nuk jam takue me ta. (Vijon)



# Irani premton 'shkeljen' e sanksioneve të ShBA-së

Presidenti iranian Hassan Rohani është përgjigjur menjëherë pas aplikimit të sanksioneve në shtetin e tij, duke thënë për televizionin shtetëror se Irani është duke u përballur me "gjendje lufte" dhe është zotuar që Irani me "krenari do t'i anashkalojë" sanksionet amerikane për të shitur naftë



Sanksionet amerikane, më të ashpra ndonjëherë

Presidenti Trump i ka cilësuar sanksionet ndaj Iranit më të ashprat ndonjëherë. "Do ta shohim se çfarë do të ndodhë me Iranin. Mirëpo ata nuk i kanë punët mirë", ka thënë ai, duke i referuar aspektit ekonomik të këtij shteti, i cili duket se është dëmtuar se pasojë e valës së parë të sanksioneve të ShBA-së. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo dhe sekretari amerikan i Thesarit, Steven Mnuchin, kanë thënë më 2 nëntor se, pavarësisht prej sigurimit të masave lehtësuese për disa shtete, Uashingtoni do t'i zbatojë sanksionet në "mënyrë agresive". Pompeo ka thënë se vendet që do të kenë lehtësira nga sanksionet në gjashtë muajt vijues janë: Kina, India, Koreja Jugore, Turqia, Italia, Greqia, Japonia dhe Tajvani. Pompeo ka thënë se kombeve që do të përjashtohen nga sank-

sionet "u duhet edhe pak kohë për të ndalur plotësisht blerjen e naftës iriane". Ai madje nuk e ka përjashtuar mundësinë që administrata amerikane t'i zgjasë këto masa për më shumë se gjashtë muaj.

Shtetet e Bashkuara kanë rikthyer sanksionet e tërhequra pas nënshkrimit të paktit bërthamor të vitit 2015, i cili parasheh lirim të Iranit nga sanksionet ndërkombëtare në këmbim të frenimit të aktivitetit bërthamor.

Presidenti amerikan është tërhequr nga pakti bërthamor në muajin maj dhe ka rivendosur sanksionet duke shënjestruar ekonominë iriane që nga muaji gusht, duke thënë se kushtet e marrëveshjes nuk kanë qenë mjaftueshëm të ashpra për të parandaluar Iranin që të mos zhvillojë armë bërthamore.

Përveç tjerash, autoritetet amerikane e akuzojnë Teheranin edhe për mbështetje të dhunës së kryer nga militantët në rajon dhe për aktivitete tjera "të dëmshme". Irani në anën tjetër ka hedhur poshtë vazhdimisht këto akuzat. Pas valës së parë të sanksioneve, ekonomia e Iranit është goditur rëndë pasi ajo ka prekur valutën e këtij shteti, çka ka rezultuar me protesta në qytetet iriane.

## Donald Tusk merret në pyetje lidhur me skemën piramidale

VARSHAVË, 5 NËNTOR - Presidenti i Këshillit të Evropës, Donald Tusk, po merret në pyetje në Poloni në vazhden e një hetimi parlamentar mbi një skemë piramidale. Mashtrimi financiar në Poloni doli në dritë në vitin 2012 kur Tusk mbante postin e kryeministrit. Prokurorët thonë se rreth 20 mijë investitorë humbën mbi 225 milionë dollarë në atë që doli se ishte një skemë piramidale. Sipas hetuesve, skema i përkiste institucionit financiar "Amber Gold", dhe se autoritetet nuk morën masat e nevojshme, me gjithë sinjalet paralajmëruese. Djali i Tuskut, Mihal kishe marrëdhënie me firmën "Amber Gold". Kritikët thonë se partia në pushtet po i përdor hetimet si një përpjekje për të diskredituar Tuskun, i cili i përket opozitës polake dhe është presidenti i Këshillit të Evropës që nga viti 2014.



### Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Salih Bytyçi"-Shkozë

Komuna: Malishevë

Data: 5 nëntor 2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/056-ESIP/SDG/056-G/1.1	Blerja dhe vendosja e kamerave të sigurisë dhe Blerja e mjeteve konkretizimi për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Salih Bytyçi", Shkozë-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Kamera të jashtme (komplet) – 6 cope
- Kamera të brendshme (komplet) – 5 cope
- Laptop :- 2 cope
- Projektor; -2 cope

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e Shkolles "Salih Bytyçi", Shkozë- Malishevë më së largu deri më 13 nëntor 2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arben Bytyçi, Tahir Sopaj  
Telefoni: 044536234 & 049446056 ,049641126  
E-maili: beni-1988@live.com

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "BTP Holding" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e vajrave, yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturine në Banjë komuna e Vushtrrisë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.12.2018. në ora 11:00 në hapësinat e restorant "Bajaska" në rrugën magjistrale Vushtrri-Mitrovicë, do të organizohet debat publik nga kompania "BTP Holding" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e vajrave, yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturine në Banjë komuna e Vushtrrisë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

## Publikohen imazhet e para të sulmit të Alec Baldwinit ndaj një qytetari



**A**lec Baldwin është në qendër të vëmendjes së një skandali rreth një parkimi në Nju Jork. Pas incidentit, ai u arrestua, dhe siç shkruan mediet e botërore, aktori ka mohuar gjatë gjithë kohës se ishte


përleshur me një qytetar i moshës 49-vjeçare. Por, tashmë në rrjetet sociale kanë filluar të qarkullonin imazhe të grindjes mes të dyve, ku aktori shihet duke e sulmuar qytetarin.

## Kendall Jenner dhe Ben Simmons janë ribashkuar?



**K**endall Jenner dhe ylli i NBA-s, Ben Simmons mund të jenë ribashkuar. Më herët gjatë kësaj jave, ylli i reality show është parë në Filadelfia në njërin nga lojërat ku luante ekipi i Simmons. "TMZ" ka

raportuar se Kendall "kishte një suitë private dhe shumë pjesëtarë të sigurimit me vete". Pas lojës, të dy janë parë duke u takuar në një vendparkim. Më pas, ata janë parë edhe në një nga vendet ku luhet bowling.



## Dua Lipa falënderon fansat për çmimin që mori në "MTV EMA"

**K**ëngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, u shpall artistja më e mirë e muzikës pop në ceremoninë e 'MTV Europe Music Awards' që u zhvillua në Bizkaia Arena në Bilbao të Spanjës. Për këtë

sukses, 23-vjeçarja i ka falënderuar fansat që ia dhanë votën. "Çmimet MTV EMA. Faleminderit fansave të mi që votuan për mua! Unë jam 'bushtra' juaj më e mirë e pop", ka shkruar Dua në "Instagram".

## Nicole Kidman ka hequr dorë prej shumë gjërave shkaku i familjes



Nicole Kidman pranoi hapur se ka hequr dorë prej disa vese dhe obligimeve të saja shkaku i familjes. Aktorja 51-vjeçare u përball me problemet që hasin çdo nënë e punësuar. Ajo po përpiqej të bënte një ekuilibër mes karrierës dhe jetës familjare. Ajo tani është nënë e katër fëmijëve që i

ka me ish-bashkëshortin Tom Cruise si dhe burrin aktual Keith Urban. "Një gjë më është dashur ta mësojë si një grua që më vonë u bë një nënë dhe si një person që ka një karrierë dhe dy fëmijë të them fjalën jo, në shumë raste", ka thënë Nicole, raporton "Daily Mail".

**E jashtëzakonshme**

## Banesa 1 euro kundër shpopullimit në Cosenza

Në Tarsia, në Cosenza të Italisë, kryebashkiaku Roberto Amoruso ka lëshuar një ide sugjестive kundër shpopullimit. Për të blerë shumë shtëpi të braktisura në trashëgiminë komunale dhe për t'i shitur ato tek çiftet e reja me çmim simbolik prej një euro. Një nismë që në realitet nuk është e re dhe që tashmë kanë



ndërmarrë qytetarë të tjerë të hershëm, në Sicili dhe Kalabri.

**FOTO E DITES**



Pjesëmarrësit që mbajnë kostume historike ngasin biçikletat e tyre me rrota të lartë gjatë garës vjetore të peniçit në Pragë /Reuters/

**E rrallë**

## Miliarderi indian i dhuron 600 vetura punonjësve të tij

Miliarderi i Hari Krishna Exporters, Sanjiv Dholakia, një nga operatorët kryesorë në tregtinë globale të tregtisë së diamantit, e cila punon 500 mijë karatë gurësh çdo vit, u largua në vitin 1977 nga fshati i lindjes Dudhala me 12 cent dhe tani kontrollon një përdorim që eksporton gurë të çmuar në 50 vende në botë. Sanjivkaka,



megjithatë, nuk e ka harruar origjinën e tij dhe ëndrrën që çdo djalë indian është rritur në fshat: të ketë një makinë. Ai punonjësve të tij u ka dhuruar 600 vetura.

**BARSOLETA E DITËS**



**Polici: Qysh more po vizitë aq shpejt, je në dijeni që të shkon leja e qarkullimit? Vozitësi: Shkon besa me e pas lejen e qarkullimit!**




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**“NIGHT SCHOOL”**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**“SIBERIA”,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**“VENOM” 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Mos kini frikë t'ju tregoni strategjitë tuaja personave që keni zgjedhur për të bashkëpunuar. Në të kundërt do të gjendeni të vetëm.</p>	 <p><b>DEMI</b> Përpiquni të mbyllni një kapitull të jetës suaj që ju ka lënduar jo pak. Me kalimin e kohës do të rikuperoni gjithçka që keni humbur në këtë fazë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Gjithçka keni bërë deri tani nuk ju ka dhënë aq vetëbesim sa shpresonit. Mbase duhet të dëgjoni persona që kanë më shumë eksperiencë se ju.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Mos u tregoni shumë të ashpër me veten sot lidhur me një situatë të caktuar. Nuk keni pasur mënyrë tjetër veprimi përveç asaj që zgjodhët.</p>	 <p><b>LUANI</b> Shumë persona po kërkojnë mendimin tuaj lidhur me çështje profesionale për të cilat dini të jeni ekspertë. Në mbrëmje familja do t'ju çlodhë.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Nëse nuk mund të merrni vendime të rëndësishme sot nuk keni pse dilni garant për zgjidhjen e disa situatave që nuk janë farë në dorën tuaj.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Vendosni afate kohore për gjëra që për ju janë të rëndësishme por të tjerët nuk po i marrin seriozisht. Nëse keni nevojë për të folur, do kërkonti partnerin.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Mos pretendoni që zgjedhjet tuaja të mos kundërshtohen nga disa persona afër jush. Në të kundërt do dukej sikur keni persona fals rreth vetes.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të mësoni një lajm që nuk do t'ju pëlqejë lidhur me jetën tuaj sentimentale. Do të ngushëlloheni duke i bërë dhurata vetes.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Energjia juaj nuk ju lë sot të bini pre e plogështisë ose e lodhjes. Edhe pse do të jeni të ngarkuar do të përballoni çdo situatë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Keni njohur persona të rinj kohët e fundit por nuk dini si ti kategorizoni. Jeni disi në panik sepse nuk dini t'u besoni apo jo.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të jetë ditë shumë e mirë sepse do të zbuloni se sa sintoni ka mes jush dhe një personi që sapo e keni njohur. Flirte të reja në horizont.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

INTER MILAN - BARCELONA

1

MONACO - CLUB BRUGGE

1

TOTTENHAM - PSV

GG3+

# Fazliu: Feronikeli përmbi Prishtinën

Astrit Fazliu ka thënë për "Epokën e re" se Feronikeli do ta fitojë ndeshjen e mbetur të xhiros së dhjetë në elitë kundër Prishtinës. Ai beson se "Nikli" është përmbi skuadrën kryeqytetase për nga cilësia në këtë edicion garash. "Prishtina është një ekip që lufton çdo vit për trofe, por nëse analizojmë ekipet për këtë edicion, mund të them lirisht se jemi më lart se Prishtina", ka thënë Fazliu

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 5 NËNTOR** - Një nga lojtarët më të mirë vitet e fundit në futbollin e Kosovës, Astrit Fazliu, ka kërkuar fitore në derbin e mbetur të xhiros së dhjetë ndaj Prishtinës, i cili zhvillohet të mërkurën nga ora 15:30. Fazliu ka thënë se "Nikli" është i favorizuar nga terreni vendës por, pavarësisht prej kësaj, synim i liderëve të elitës në çdo takim është fitorja, përfshirë edhe ndeshjen ndaj Prishtinës. "Të mërkurën takohen dy skuadrat më të mira në këtë edicion, Feronikeli dhe Prishtina, në ndeshjen e mbetur. Ne jemi mobilizuar maksimalisht dhe me seriozitetin me të madh i kemi marrë si ndeshjet e lehta ashtu edhe ato të vështira. Jemi të favorizuar nga terreni vendës, prandaj synimi ynë si në çdo ndeshje tjetër është fitorja", ka thënë Fazliu të hënën për "Epokën e re".

Sulmuesi që edicionin e kaluar u shpall kampion me skuadrën e Prishtinës në të kaluarën ka qenë pjesë e Prishtinës. Ai ka thënë fjalë të mira për ish-skuadrën, por për këtë edicion beson se Feronikeli ka skuadër më cilësore. "Prishtina është një ekip që lufton çdo vit për trofe, por nëse analizojmë ekipet për këtë edicion, mund të them lirisht se jemi më lart se Prishtina", ka thënë Fazliu.

Astrit Fazliu që ka bërë karrierë edhe në futbollin shqiptar, pret përkrahje të madhe nga tifozët



"tigrat e zi", pasi të mërkurën në Drenas përballen dy skuadrat e para në renditjen tabelore. "Kjo ndeshje nuk është vendimtare për titull, por ka rëndësi të madhe për dy klubet, për faktin se secili prej tyre synon ta marrë maksimumin për të qenë sa më mirë me pikë në tabelën e klasifikimit, prandaj edhe interesimi tek shikuesit besoj se do të jetë i madh. Pres përkrahje edhe më të madhe nga tifozët tanë në këtë ndeshje dhe në fund do t'i gëzohemi fitores", ka deklaruar

Fazliu.

Në ndeshjen e fundit, të vlefshme për xhiron e 14-t, Feronikeli e mposhti Ballkanin me rezultat 0-1, kurse me rezultat të njëjtë fitoi edhe Prishtina në Skenderaj ndaj Drenicës. Aktualisht "Nikli" pozicionohet në pozitën e parë me 32 pikë të grumbulluara, duke regjistruar dhjetë fitore, dy barazime dhe një humbje. Ndërsa skuadra "bardhekaltër" është e dyta me dy pikë më pak, kurse ka regjistruar nëntë fitore, tri barazime dhe një humbje.

SHKURT

## Khaka: Pretendojmë një nga katër vendet e para

Granit Khaka po paraqitet mirë për Arsenalin, kurse trajneri Unai Emery ka besim te lojtari me origjinë shqiptare dhe është një titullar i padiskutueshëm. "Në çdo ndeshje ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë. E kuptojmë mjaft mirë pozitën kur bëjmë ndeshje të mira, por edhe kur nuk luajmë mirë. Emery është i rëndësishëm për ne. Më ka ndihmuar jo vetëm mua, por të gjithë lojtarët, qoftë dhe me detaje të vogla. Gjërat po ndryshojnë gradualisht. Skuadra ka karakter edhe kur jemi duke humbur si në rastin kur po luanim me Liverpoolin që arritëm t'i gjenim forcat e të barazonim. Nuk është hera e parë që e bëmë diçka të tillë. Për lojën që bëmë nuk duhet të mundeshim në atë ndeshje. Duke marrë në konsideratë atë çka treguam në këtë takim, them se jemi pretendentë për të qenë në një nga katër vendet e para", ka thënë Khaka, i cili është i kënaqur me paraqitjen ndaj Liverpoolit që është një kundërshtar me shumë cilësi.

## Lazio "blindon" Taren

Skuadra e Lazios e ka "blinduar" shqiptarin Igli Tare i cili mban detyrën e drejtorit sportiv në këtë klub. Mediet italiane raportojnë se Tare ka nënshkruar zgjatjen e kontratës edhe për dy vjetet e ardhshme me pagë të dyfishuar. Shqiptari do të përfitojë diçka më shumë se 1 milion euro në sezon, me të drejtë rinovimi edhe për dy sezone të tjera. Interesim për Taren kishin shfaqur edhe Interi dhe Milani.

## Greзда kritikohet nga tifozët, por mbrohet nga Gerrardi

Eros Grezda është kritikuar nga tifozët për paraqitjen në ndeshjen si titullar që Rangersi e fitoi ndaj ST. Mirren (0-2). Mirëpo futbollisti kuqezi është mbrojtur nga trajneri Steven Gerrard, i cili ka besim të madh në aftësitë e Grezdes. "Mendoj se me kalimin e minutave ai u rrit ndjeshëm sa i përket lojës. Momentet më të mira i pati pak para se të zëvendësohej, pra pesë minutat e fundit që qëndroi në fushë. Goditi shtyllën dhe, nëse topi do të shkonte në rrjetë, do ta kishte ndihmuar shumë. Të mos harrojmë që kur erdhi te Rangersi pati një dëmtim të rëndë dhe iu desh kohë për t'u kthyer. Unë kam besim se do të përmirësohet më shumë", ka thënë Gerrardi.

## Bardhi shkon te Besa

Një nga lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës, Bardh Kelmendi, e ka përforcuar ekipin e Besës. Kelmendi ishte pjesë e skuadrës së Feniksit nga Drenasi, por pas shuarjes së tij ai ka vendosur t'i bashkohet ekipit pejan. "Bardh Kelmendi ka vendosur t'i bashkohet Besës në rrugëtimin drejt titullit dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare. Kelmendi zgjodhi FC Besën duke e ditur rëndësinë dhe peshën e madhe që ky klub ka për sportin dhe futbollin kosovar", thuhet në njoftimin e Besës.

## Kloppi nuk e merr Shaqirin në Beograd

**LIVERPOOL, 5 NËNTOR** - Xherdan Shaqiri nuk do të jetë në Beograd përsfidën që Liverpooli do të luajë të martën ndaj Crvena Zvezdës. Lajmi për lënien jashtë të futbollistit me origjinë shqiptare është konfirmuar nga trajneri Jurgen Klop, i cili, për shkak të kërcën-

imeve të shumta në drejtim të futbollistit, ka vendosur mos ta grumbullojë atë. Tekniku gjerman është i bindur që Shaqiri do ta kuptojë për vendimin e marrë. "Kemi dëgjuar spekulimet dhe flasim për pritjen që Shaqiri do të merre dhe megjithëse nuk kemi

ide se çfarë do të ndodhte, ne do të shkojmë dhe duam të jemi të përqendruar vetëm te futbollin e nuk duhet të mendojmë për ndonjë gjë tjetër. Ne jemi Liverpooli, një klub i madh, një ekip futbollit dhe nuk kemi asnjë mesazh përtej kësaj. Ne nuk kemi

mesazhe politike. Duam që fokusi të jetë në një ndeshje futbollit. Pra, për këtë arsye, Shaqiri nuk është i përfshirë dhe ai e pranon dhe e kupton këtë. Shaqiri është lojtari ynë, e duam dhe do të luajë për ne shumë herë, por jo të martën", ka thënë Kloppi.



## Mourinho shkarkohet nëse Unitedi humbet nga Juventus

MANCHESTER, 5 NËNTOR - Jose Mourinho sërish rrezikon të shkarkohet nga detyra e trajnerit të Manchester Unitedit nëse kjo skuadër pëson humbje nga Juventus

në Ligën e Kampionëve. Ai ka shprehur dëshirë që ta përfundojë deri në fund kontratën me "djajtë e kuq" dhe së fundmi këtë dëshirë e ka treguar edhe me rezul-

tatet e fundit. 55-vjeçari e ka shpëtuar veten së fundmi nga shkarkimi por, sipas asaj që bën me dije "Daily Mail", përsëri në Manchester flitet se në rast humbje ndaj

Juventusit, portugezi Mourinho do të shkarkohet, pasi rezultati negativ do të vinte në dyshim kalimin e fazës së grupeve nga skuadra angleze.



## Interi për 'hakmarrje' ndaj Barçës, Napoli pret PSG-në



MILANO, 5 NËNTOR - Interi dhe Barcelona përballen sonte (e martë) në kuadër të Grupit B në Ligën e Kampionëve. Barcelona para dy javësh fitoi në "Camp Nou", por edhe një fitore tjetër do ta siguronte kualifikimin tutje. Ndërsa Interi do të mundohet të marrë fitore në këtë ndeshje në mënyrë që ta ketë më të sigurt kualifikimin, pasi Tottenham Hotspur do të luajë ndaj PSV-së dhe me gjasë do të shënojë fitore. Lajm i mirë për mysafirët dhe i keq për vendasit është rikthimi i Lionel Messit nga lëndimi, por ende nuk dihet se a do të startojë argentinasi nga fillimi apo në pjesën e dytë. Megjithatë, skuadra e Interit është duke kaluar çaste të mira dhe në këtë ndeshje hynë pas fitores në Serinë A kundër Genoas me rezultat 5-0. Sonte

zhvillohet edhe një tjetër ndeshje derbi. Napoli e pret skuadrën e Paris Saint Germainit, me të cilën luajti para dy javësh baras (2-2), por të dyja këto skuadra në këtë ndeshje kanë synim fitoren në mënyrë që t'i ofrohen më shumë kualifikimit për fazën tjetër në Ligën e Kampionëve. Napoli zë vendin e dytë me pesë pikë, kurse PSG-ja është e treta me një pikë më pak. Vendi i parë e mban në këtë grup Liverpooli që do të luajë kundër Crvena Zvezdas në Beograd. Në këtë ndeshje Jurgen Kloppi ka vendosur të mos e ftojë Xherdan Shaqirin për t'u ikur sa më shumë tensioneve me tifozët serbë, të cilët janë të revoltuar me futbollistin shqiptar, i cili, pas i shënoi Serbisë në Kupën e Botës, festoi golin duke bërë me duar, në shenjë simbolike, shqiponjën.

GRUPI A		
18:55 Monaco - Club Brugge		
21:00 Atletico Madrid - Borussia Dortmund		
TABELA		
		PIKË
1. Borussia Dortmund	3	9
2. Atletico Madrid	3	6
3. Monaco	3	1
4. Club Brugge 3 1		
GRUPI B		
21:00 Inter - Barcelona		
21:00 Tottenham H. - PSV Eindhoven		
TABELA		
		PIKË
1. Barcelona	3	9
2. Inter	3	6
3. Tottenham H.	3	1
4. PSV Eindhoven	3	1
GRUPI C		
18:55 Crvena Zvezda - Liverpool		
21:00 Napoli - Paris Saint Germain		
TABELA		
		PIKË
1. Liverpool	3	6
2. Napoli	3	5
3. PSG	3	4
4. Crvena Zvezda	3	1
GRUPI D		
21:00 Porto - Lokomotiv M.		
21:00 Schalke - Galatasaray		
TABELA		
		PIKË
1. Porto	3	7
2. Schalke	3	5
3. Galatasaray	3	4
4. Lokomotiv M.	3	0

## Toronto, 'leksion' lakersave, kryeson renditjen në Lindje

TORONTO, 5 NËNTOR - Skuadra e Torontos ka triumfuar 121-107 ndaj lakersave, takim i zhvilluar në Los Angeles, duke korrur suksesin e nëntë sezonal, fitore që mban ekipin kanadez në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes. Një sfidë mjaft e mirë nga ana e basketbollistëve të Torontos, që ishin gjatë gjithë kohës padronë të fushës, edhe pse luhej në Kaliforni. Kuzma me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë për Lakersin, ndërsa për miqtë u dallua Ibaka me 34 pikë e 10 rebaunde, mbështetur edhe nga Lowry me 21 pikë e 15 asistime. Humbet edhe skuadra e San Antonios, që u mund 117-110 në fushën e vet nga Orlando, sfidë ku skuadra mike dominoi vazhdimisht, madje duke u shkëputur deri në 30 pikë.



DeRozan realizoi 25 pikë, por që mbetën për statistikë për Spursin, ndërsa për miqtë u dallua Gordoni me 26 pikë. Vijon sezoni pozitiv i Milwaukeees, që mposhti me lehtësi 144-109 Sacramento, duke qenë forca e dytë në Lindje. Sfidë me sens unik, gjithnjë e kontrolluar nga vendasit, ku u dallua Antetokounmpo me 26 pikë, 15 rebaunde e 11 asistime. Në ndeshjet e tjera të luajtura sot, spikat fitorja e Washingtonit, 108-95 ndaj New Yorkut, sfidë ku difer-

encën në fushë e bënë Wall me 26 pikë e Beal me 22. Fiton edhe Portlandi, 111-81 ndaj Minnesotas, ndeshje e komanduar nga basketbollistët vendas, me Nurkic që realizoi 19 pikë e 12 rebaunde. Pa probleme fiton Brooklyn, që mundi 122-97 Philadelphian, ku Hollis-Russell-levert realizuan 62 pikë së bashku. Phoenixi triumfoi në sekondat e fundit 102-100 ndaj Memphisit falë 25 pikëve të Bookerit.

REZULTATET	
Milwaukeee - Sacramento	144-109
Brooklyn - Philadelphia	122-97
Washington - New York	108-95
San Antonio - Orlando	110-117
Phoenix - Memphis	102-100
Portland - Minnesota	111-81
Lakers - Toronto	107-121

### SHKURT

#### Ndërroi jetë skiatori zviceran

Ditë zie për sportin e skive. Zvicerani Luca Barandum, 24-vjeç, ka ndërruar jetë ditën e diel, pas një aksidenti me parashutë, lajm që konfirmohet nga mediet helvete. Ngjarja tragjike ka ndodhur në qytezën e Schluein, në kantonin e Grigioni. Rreth orës 11:00, teksa Barandum po ulej me parashutë në zonën e caktuar, ka pësuar një incident. Për policinë rrethanat e aksidentit janë ende të paqarta, ndaj është duke hetuar për këtë ngjarje. Barandum ka debutuar në vitin 2017 në garat e Kupës së Botës në ski, në pistën austriake të Èengen dhe në total ka marrë pjesë në 17 gara. Rezultati i tij më i mirë në Kupën e Botës është një vend i nëntë, në pistën e Bormio, sezonin e fundit.

#### Romagnoli: Fitore e merituar

Kapiteni i Milanit, Alessio Romagnoli për herë të dytë e volum fitoren e Milanit në minutat e fundit të ndeshjes. Mbrojtësi shënoi golin e fitores në ndeshjen ndaj Udineses, e cila përfundoi 0-1. "Tentoj të jap më të mirën gjithmonë, dhe shpresojmë që të vazhdojmë kështu. Të gjithë luajmë këtu për një klub të madh dhe dëshirojmë të japim më të mirën. Ishte një ndeshje madhështore, kishim vështirësi në pjesën e parë, mirëpo pastaj luftuam dhe morëm fitore. Kjo është ndoshta koha më e mirë që prej se jam në Milan, por shpresoj që më e mira të vije", ka thënë Romagnoli.

#### Ronaldo: Dua të luaj përsëri me Rooney

Ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo, ka lënë të kuptohet se ai dëshiron të bashkohet përsëri me ish-bashkëlojtarin e tij gjatë kohës në Manchester United, Wayne Rooney, para se t'i japin fund karrierës në futboll. Këta dy golashënues legjendar kishin kaluar shumë vite së bashku në "Old Trafford", ku kishin shijuar suksese në Premierligë dhe në Ligën e Kampionëve. Por, tani që të dy e kanë vazhduar karrierën e tij larg "Djajve të kuq", Ronaldo në Juventus dhe Rooney në DC United. Ronaldo nënshkroi kontratë katërvjeçare me Juventusin këtë verë, ndërsa Rooney nënshkroi kontratë trevjeçare e gjysmë me klubin amerikan. Përkundër kësaj, portugezi ka bërë të ditur se do t'i pëlqente të punonte me ish-bashkëlojtarin e tij përsëri. "Për mua, pika më e fortë e Wayne Rooneyt është mendësia dhe fuqia e tij. Ai nuk ndalon asnjëherë, ai gjithmonë vrapon, i ndihmon skuadrën. Ai është lojtar fantastik për skuadrën dhe shënon shumë gola. Ai shënon gola të rëndësishme, ai është fantastik", ka thënë Ronaldo. "Ai ishte fëmija i Anglisë. Të gjithë e donin atë. Ai është një djalosh fantastik dhe një futbollist i mrekullueshëm. Unë dhe shokët e mi e thërrisim atë 'Pit Bull'. E mbaj mend se kur e humbiste topin, ai ishte shumë i fuqishëm. Ai e gjuan topin në mënyrë të pabesueshme. I ka shënuar shumë gola, çfarë mund të them? Më mungon të luaj me të. Askush nuk e di të ardhmen. Ndoshta ne do të luajmë përsëri së bashku ndonjë ditë", ka deklaruar Ronaldo.

#### Montoya: Neymari dëshiron të rikthehet në "Camp Nou"

Ylli brazilian Neymar po dëshiron rikthimin në Barcelonë. Kështu ka bërë të ditur ish-bashkëlojtarin e tij, Martin Montoya. Ylli i Paris Saint-Germain la Camp Nou në vitin 2017, kur ju bashkua parisienëve për 222 milionë euro. Por megjithatë, spekulimet nuk kanë pushuar për një mundësi që ribashkimit me Lionel Messi dhe Luis Suarez. "Nuk e di, është e vështirë të bëhet. Paris është ekip i madh dhe nuk mendoj se do ta lënë lehtë që të largohet. Ata kanë paguar shumë të madhe për të paguar për ta bërë dhe nuk mendoj se ata Barcelona është e gatshme të paguajë aq për ta rikthyer. Mendoj se Neymar e do rikthimin sepse atje ishte i rehatuar dhe adaptuar për tre vjet sa ishte në atë klub. Ai ka lidhje me Suarezin dhe Messin. Megjithatë mendoj se një kthim i tij në Barcelonë është vështirë i mundshëm", ka thënë Montoya.



## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "V.Fraseri"- Drenoc  
Komuna: Rahovec  
Data: 06.11.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/102-G/1.1	Furnizim me mjete të TIK-ut dhe me mjete didaktike dhe të konkretizimit

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Vellezerit Fraseri"- Drenoc - Rahovec . Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Projektor—1 cope
- Llap-top—5 cope
- Kabinet i kimise- 1cope

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtëm teknik në adresën e shkolles "Vellezerit Fraseri"- Drenoc – Rahovec, më së largu deri më 14.11. 2018.

4. Specifikimi i hollësishtëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Driton Krasniqi  
Telefoni: 044601003  
E-maili: driti\_7@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Lidhja e Prizrenit"- Optrushë  
Komuna: Rahovec  
Data: 6.11.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/096 - ESIP/SDG/096-G/1.2	Kabineti shkencave të natyrës:Fizikë, Biologji, Kimi, Gjeografi dhe Matematikë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Lidhja e Prizrenit"-Optrushë - Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Kabineti shkencave të natyrës:Fizikë, Biologji, Kimi, Gjeografi dhe Matematikë

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtëm teknik në adresën e shkolles "Lidhja e Prizrenit"- Optrushë – Rahovec, më së largu deri më 14.11. 2018.

4. Specifikimi i hollësishtëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Skender Krasniqi,Liridon Berisha  
Telefoni: 044/366-516 ,049/488-513  
E-maili: skrasniqi@live.com



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Financave -Ministarstvo za Finansija-Ministry of Finance**

Ministria e Financave, mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, Për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, dhe Rregullores nr. 02/2010, "Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të realizimit të procedurës së rekrutimit për pozitën, Zhvillues dhe Administrator i lartë i Sistemeve softverike, Shpallë këtë:

**KONKURS**

**Titulli i pozitës: Zhvillues dhe administrator i lartë i sistemeve softverike (3 pozita)**

**Numri i referencës : 22/2018/ DTI-MF**

**Grada e vendit punës: Niveli profesional**

**Koeficienti: 8**

**Detyrat dhe Përgjegjësit:**

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
- Kryen detyrat të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Zhvillon, menaxhon dhe operon me Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB), Programin e Investimeve Publike (PIP) si dhe ofron këshilla dhe rekomandime përdoruesve dhe zyrtarëve të buxhetit qendror dhe lokal për përmirësimin e kapaciteteve të tyre përkitazi me planifikimin-hartimin e buxhetit
- Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
- Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
- Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
- Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathësi hulumtues, analitik, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Njohuri të thellë në ndonjërin nga gjuhët programuese si: java; NET; shumë e dëshirueshme në PHP.
- Njohuri të thellë në administrim të bazave të shënimeve në një nga platformat si: Oracle; SQL; My SQL. (shumë e dëshirueshme) ;
- Diplomë universitare – Fakulteti i shkencave kompjuterike;
- Minimum tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohja e gjuhës angleze (në të shkruar dhe të folur) dhe gjuhëve tjera është përparësi.

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Ministria e Financave ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), letërnjoftimin, Dëshminë e përvojës së punës dhe dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (ruga Nënë Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <https://mf.rks-gov.net/>

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i XII, zyra nr. 1207. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit. Kohëzgjatja e emërimit sipas I.SHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

**Afati i konkurrimit është prej datës 06/11/2018 deri me datë 20/11/2018, deri në orën 16:00.**

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038/200/34/196; 038 200 34 155.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec  
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br. 2978  
Me datë/dana.05.11.2018  
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02  
Obraz. MJU-CSK-02

## SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucioni/ Komuna e Rahovecit / kërkon të punësojë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa .  
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Odeljenje za Budžet i Finansije.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Arkatar (1 pozitë)
- Blagajnik (1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: A4-G11 / koeficienti i pagës 6.  
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: A4-G11/koeficijent plate 6.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto : AD/160/ JP00034033.

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/  
(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):  
menaxhon dhe mirëmban të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion; 25%  
kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion; 15%  
planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme; 15%  
mban evidencë për shpenzimet e parasë së gatshme dhe i sistemon ne regjistrator përkatës; 15%  
rishikon raportet, format, dhe të dhënat për saktësinë, plotësinë, dhe përpunshmërinë e tyre lidhur me shpenzimet e parave të gatshme; 15%  
bën barazimin ditor në bankën kompetente; 7%  
kujdeset për ruajtjen dhe arkivimin e bllok dëftesave; 5%  
paraqet raporte punë mujore, periodike dhe vjetore; 2%  
kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së epërorit që janë në pajtim me ligjin; 1%  
rukodori i održava sve prenose novčanih sredstava u instituciji; 25%  
stara se za sigurnost novčanih sredstava u instituciji; 15%  
planira i vrši kontrolu potrošnje svih novčanih troškova; 15%  
vodi evidenciju za potrošnju novčanih sredstava i sistemira u dotični folder; 15%  
proverava izveštaje i podatke da bi potvrdio način potrošnje novčanih sredstava; 15%  
priprema izveštaj sitnih novčanih sredstava, i izveštaj o stanju trezora; 7%  
čuva i ubaciva u arhivu blok paragone (blok potvrde); 5%  
izrađuje mesečni, periodični i godišnji izveštaj o radu -2%  
vrši i ostale dužnosti prema zahtevu starešine, a koje su u skladu sa zakonom - 1%  
Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učesće na regrutaciji/

[Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil  
/ Navedite uslove za učesće u procesu regrutacije po Zakonu o Javnoj Službi]

Kandidati përveç kushteve të lartë shënuar duhet të plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas ligjit mbi shërbimin civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës, të mos jenë nën hetime penale apo i dënuar për veprë penale . Kandidat osim gorenavedenih uslova treba da ispuni i opšte uslove predviđene zakonom o civilnoj službi br. 03/L-149, kao i Kosovskih zakona koji su u primeni , da nije pod krivičnom istragom ili kažnjen zbog krivičnog dela.

### Procedurat e konkurrimit/ Postupak konkurisanja/

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civil ekzistues  
- Navedite ukoliko je procedura za konkurisanje javno objavljena i za javne službenike koji rade u instituciji ili je interna procedura za službenike koji već rade:

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues edhe për kandidatët e jashtëm .Postupak konkurisanja je otvoren kako za postojeće civilne službenike tako i za spoljne kandidate .

### Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/:

[Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/Upišite realno potrebno obrazovanje za obavljanje ovog posla]

Përgatitja shkollore : Diplom bachelor-drejtimi ekonomi, banka, financa, menaxhment

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/:

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/:

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/:

Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative

Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara  
Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët

Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik  
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)  
Diplom bachelor-drejtimi ekonomi, banka, financa, menaxhment  
Së paku katër (4) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative  
Poznavanje standardnih administrativno/tehničkih postupaka u nekoj poznatoj tehničkoj ili administrativnoj oblasti  
Sposobnost da radi samovoljno u okviru odrednih planova i postupaka,  
Dobre sposobnosti komunikacije, uključujući sposobnost tumačenja informacija, uputstva ostalim,  
Sposobnost nadzora i koordinacije rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou,  
Sposobnost rada kompjuterskim aplikacijama programa (Word, Excel, Power Point, Access)  
Najmanje 4 godine radnog iskustva dotičnog tehničko ili administrativne oblasti

### Dokumentet që kërkohen:

- Diplomë
- Diplomu
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- Potvrda da nije pod istragom
- CV-ja
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Izvod Rodenja
- Kopja e letërnjoftimit
- Kopija lične karte
- Dëshmi e përvojës së punës
- Dokaz o radnom iskustvu

### Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin/Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

[Shënoni një përshkrim të shkurtër të përzgjedhjes dhe të rregullorevë ekzistues që rregullojnë rekrutimin / Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje]

Kandidatët e sukseshëm do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 .  
Uspešni kandidat uputiće se na pismenom testiranju i usmenom intervjuisanju. Izbor će se izvršiti na osnovu zakona o Civilnoj Službi i Pravilnika za Regrutaciju br. 02/2010

### Kohëzgjatja e emërimit /Vremenski rok imenovanja:

[Shënoni nëse emërimi është me kohë të caktuar ose me kohë të pacaktuar dhe periudhën e kohëzgjatjes/ Naznačite ako imenovanje je na određeno vreme ili na neodređeno vremenski rok]:

Në kohë të pacaktuar.Na neodređeno vreme.

### Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa:

[Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/ Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok].

Afati i Konkursit është 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik. Rok za konkurisanje je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

### Paraqitja e kërkesave/Prijava zahteva-Podnošenje zahteva/

[Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues  
/ Navedite kako i gde se mogu dobiti obrazci za konkurisanje i mesto gde može predati i tačna adresa institucije]

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e pranimit në objektin e Komunës së Rahovecit  
Adresa:Rruga„Xhelal Hajda-Toni" pn. Rahovec.Aplikacije se mogu podići i dostaviti pri prijemoj kancelariji u objektu Opštine Orahovac.Adresa: Ul." Xhelal Hajda-Toni" b.b Orahovac.

### Kërkesat specifike / Specifični zahtevi

[Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekësor  
/ Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizike prirode za izvršavanje radnih obaveza, sa zahtevom za mišljenje lekara].

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

-Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljani proporcionalno u organima Javne službe na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno i Čl. 11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Priljeni zahtevi nakon zatvaranja konkursa neće biti prihvacene. Nekompletirani zahtevi biće odbijeni.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen/Usled velikog broja primljenih zahteva, bice pozvani samo kandidati koji su ušli u uzi izbor.

Shënoni emri dhe mbicmri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Napišite ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica:

Ymret Reshiti, Udhëheqës i Personelit, tel:044/203-914.  
Ymret Reshiti, Rukovodilac Osoblja, tel:044/203-914.

Udhëheqësi i Personelit  
Rukovodilac Osoblja  
Ymret Reshiti



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec  
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br.2979  
Me dt./dana.05.11.2018  
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02  
Obraz. MJU-CSK-02

## SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucioni/ Komuna e Rahovecit / kërkoni të punësoj në Zyrën e Kryetarit të Komunës.  
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Kancelariji Predsednika opštine.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Udhëheqës i sektorit për komunitete dhe kthim (1 pozitë)
- Rukovodilac sektora za zajednice u povratka (1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: D1-G7 / koeficienti i pagës 9.  
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: R1-S7/koeficijent plate 9.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto : ZK01/2018; KP01/2018.

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/  
(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):

- koordinon punën në sektor dhe është përgjegjës për stafin e saj-10%
- rukovodi rad sektora i odgovoran je za osoblje 10%
- kujdeset për të drejtat e komuniteteve dhe për kthim dhe angazhohet plotësisht në integrimin e komuniteteve në kuadër të institucioneve komunale-20%
- stara se za prava zajednice i povratka i angazhuje se u potpunosti za integraciju zajednice u okviru opštinskih institucija 20%
- mbikëqyr të drejtat e komuniteteve dhe përdorimin e gjuhëve-15%
- nadzire prava zajednice i korišćenja jezika 15%
- monitoron në përputhshmëri respektimin e standardeve për të drejtat e komuniteteve ,integrimin dhe kthimit të qëndrueshëm-10%
- nadzire poštovanje u potpunosti standarda prava zajednice, trajnu integraciju i povratka 10%
- paraqet raport në çdo takim të Komitetit për Komunitete, duke përshkruar hollësisht punën e kryer si pjesë e mandatit të sektorit-5%
- dostavlja izveštaj za svaki sastanak Komiteta za Zajednice, opisajući u detalje izvršene radove kao deo mandata sektora 5%
- sipas kërkesave, informon dhe paraqet raport, tek institucionet e qeverisë qendrore, lidhur me aktivitetet e sektorit-5%
- prema zahtevu,informiše i dostavlja izveštaj institucijama centralne vlade o aktivnostima sektora 5%
- i propozon Kryetarit të Komunës një buxhet vjetor për të siguruar funksionim të duhur të zyrës dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kompetencave të veta-2%
- predlaže Predsedniku opštine godišnji budžet u cilju obezbeđivanja normalnog rada kancelarije i sprovođenja projekata i aktivnosti na osnovu njegovih nadležnosti 2%
- harton dhe zhvillon planet e veprimt, identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve rreth integrimin të komuniteteve, të drejtave të komuniteteve dhe kthimit të qëndrueshëm -15%
- Izrađuje i sprovodi plan delovanja, identifikuje potrebe za povećanje kapaciteta integracije zajednice, prava zajednice i trajnog povratka 15%
- përcjell zbatimin e ligjeve, planet dhe strategjitë e miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës rreth integrimin të komuniteteve, të drejtave të komuniteteve dhe kthimit të qëndrueshëm-10%
- prati sprovođenje zakona, planova i strategija usvojenih od Vlade i Skupštine Republike Kosova za integraciju, prava i trajni povratka zajednice 10%
- bashkëpunon ngushtë me institucionet e qeverisë qendrore dhe me organizata të tjera vendore e ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve, kthimit dhe ri-integrimin-4%
- blisko saraduje sa institucijama centralne vlade i ostalim domačim i međunarodnim organizacijama koje vrše delatnost prava zajednice, povratka i njihove reintegracije 4%
- paraqet raporte punë mujore, periodike dhe vjetore -3%
- dostavlja mesečni, periodični i godišnji izveštaj 3 %
- kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit që janë në pajtim me ligjin-1%
- vrši i druge poslove a na zahtev starešine koji su u skladu sa zakonom 1%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

[Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil

/Navedite uslove za učešće u procesu regrutacije po Zakonu o Javnoj Službi]

Kandidati përvojë kushtet të lartë shënuar duhet ti plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas ligjit mbi shërbimin civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës,të mos jenë nën hetime penale apo i dënuar për vepër penale .

Kandidat osim gorenavedenih uslova treba da ispuni i opšte uslove predviđene zakonom o civilnoj službi br. 03/L-149, kao i Kosovskih zakona koji su u primeni , da nije pod krivičnom istragom ili kažnjen zbog krivičnog dela.

Procedurat e konkurrimit/ Postupak konkurisanja/

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civil ekzistues

- Navedite ukoliko je procedura za konkurisanje javno objavljena i za javne službenike koji rade u instituciji ili je interna procedura za službenike koji već rade:

Procedura e konkurrimit është e hapur , të drejtë konkurimi kanë vetëm kandidatët e komuniteteve pakicë në Kosovë (serb,RAE,turq,malazez,kroat etj) .

Postupak konkursa je otvoren, pravo konkursa imaju samo kandidati manjinskih zajednica na Kosovu (srbi, R.A.E, turci, crnogorci, hrvati, itd).

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/:

[Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune

/Upišite realno potrebno obrazovanje za obavljanje ovog posla]

Përgatitja shkollore : Diplomë universitare -drejtimi juridik, administratë, ekonomi, shkenca politike.

Školska sprema: Univerzitetska diploma - pravnog, administrativnog, ekonomskog, smer a ili smer a političke nauke .

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

[Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mundin me qenë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive

/Opišite sposobnosti, iskustvo i licne osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One treba da su u vezi sa radom i da su objektivne ]:

- Njohuri dhe përvojë substanciale në menaxhim
- Znatno iskustvo i znanje u rukovodenju
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim

- Sposobnost rukovodenja komunikacije, pregovora i ubedljivosti;
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë
- Sposobnost određivanja ciljeva, planiranja i analize rada;
- Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues
- Sposobnost rukovodstva i organizacije ekipe, sposobnost rukovodenja ekipe ili radne grupe;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)
- Sposobnost rada na kompjuteru (Word, Excel, Power Point, Access);
- 4 vite përvojë pune profesionale –e preferueshme
- Najmanje 4 godine stručnog radnog iskustva – poželjno.
- Dokumentet që kërkohen:
- Diploma
- Diploma
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- Potvrda da nije pod istragom
- CV-ja
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Izvod Rodenja
- Kopja e letërnjoftimit
- Kopija lične karte
- Dëshmi e përvojës së punës
- Dokaz o radnom iskustvu
- Të gjithë ata kandidat që kanë diplomë të fituar në institucionet e akredituara dhe pranuar të arsimin të lartë në territorin Republikës së Serbisë, duhet të sjellin dëshmi për pranimin dhe barazvlerësimin e diplomës nga MASHT-Ministria e Arsimit ,Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës ose certifikatën e përkthyer në gjuhën shqipe të lëshuar nga Asociacioni i Universiteteve të Evropës-AUV
- Svi kandidati koji su dobili diplomu od priznatih i akreditovanih institucija visokog obrazovanja na teritoriji Republike Srbije, treba da donesu dokaz priznavanja i procene jednakosti diplome od M.O.N.T –a ( Ministarstva za Obrazovanje, Nauke i Tehnologije Kosova), ili svedočanstvo prevedeno na Albanskom jeziku, izdato od Asocijacije Univerziteta Evrope, A.U.V.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

/Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

[Shënoni një përshkrim të shkurtë të përzgjedhjes dhe të rregulloreve ekzistuese që rregullojnë rekrutimin

- Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje]

Kandidatët e sukseshëm do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.Përzgjedhja

bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 .

Uspešni kandidati uputiće se na pismenom testiranju i usmenom intervjuisanju. Izbor će se izvršiti na osnovu zakona o Civilnoj Službi i Pravilnika za Regrutaciju br. 02/2010

Kohëzgjatja e emërimit /Vremenski rok imenovanja:

[Shënoni nëse emërimi është me kohë të caktuar ose me kohë të pacaktuar dhe periudhën e kohëzgjatjes

/Naznačite ako imcnovanje je na određeno vreme ili na neodređeno vremenski rok]:

Në kohë të pacaktuar.

Na neodređeno vreme.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa :

[Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes

/Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok].

Afati i Konkursit është 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Rok za konkurisanje je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

Paraqitja e kërkesave/Prijava zahteva-Podnošenje zahteva/

[Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues

/Navedite kako i gde se mogu dobiti obrazci za konkurisanje i mesto gde može predati i tačna adresa institucije]

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e pranimit në objektin e Komunës së Rahovecit

Adresa:Rruga„Xhelal Hajda-Toni" pn. Rahovec.

Aplikacije se mogu podići i dostaviti pri prijemnoj kancelariji u objektu Opštine Orahovac.

Adresa: Ul." Xhelal Hajda-Toni" b.b Orahovac.

Kërkesat specifike / Specifični zahtevi

[Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës,

përfshirë kërkesën për vlerësim mjekësor

/Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizike prirode za izvršavanje radnih obaveza, sa zahtevom za mišljenje lekara].

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

